

Telkom i Kosovës S. A.
Kosovo Telecom J. S. C.
Telekom Kosovo D. O.
Nr./No./Br. 01-154824
Data/Date/Datum 18-03-24

PRIŠTINË, PRISTINA, PRIŠTINA



RAPORTI VJETOR PËR AKTIVITETET E TELEKOMIT TË KOSOVËS SH.A. PËR VITIN 2023

VENDIM

Bordi i Drejtorëve të Telekominës miratoi Raportin Vjetor të TK Sh.A. për vitin 2023 në mbledhjen me nr. 55 të mbajtur me datë: 18.03.2024



Delegoi

Burbuqe Hana

Kryeshefe Ekzekutive - Telekomi i Kosovës Sh.A.

Nënshkrimi

Data

18/03/2024



Aprovoi

Shpëtim Dobra

Kryesues i Bordit të Drejtorëve - Telekomi i Kosovës Sh.A.

Nënshkrimi

Data



I.	Lista e Tabelave	2
	Shkurtesat	3
II.	PROFILI I SHKURTËR I KOMPANIË	4
III.	RAPORTI I KRYESUESIT TË BORDIT TË DREJTORËVE	5
A.	AKTIVITETET DHE PERFORMANCE E NDËRMARRJES SË TK-SË	7
B.	INFORMACIONE LIDHUR ME KAPITALIN DHE DIVIDENTËN	8
C.	TË DHËNAT PËR DREJTORËT JOEKZEKUTIV	9
IV.	FJALA HYRËSE E KRYESHEFES EKZEKUTIVE TË TELEKOMIT TË KOSOVËS	10
V.	RAPORTI I KRYESHEFES EKZEKUTIVE	11
A.	NGJARJET KRYESORE TË VITIT	12
B.	PASQYRAT E TREGUT TË TELEKOMUNIKIMEVE NË KOSOVË	16
C.	PASQYRA E PERFORMANCES OPERATIVE DHE REZULTATET E INDIKATORËVE KYÇ TË PERFORMANCES	21
D.	PASQYRA E PERFORMANCES FINANCIARE DHE REZULTATET 2023	22
E.	PROGRESI ME PLANIN E BIZNESIT	25
F.	SHPENZIMET KAPITALE DHE PROJEKTET	26
G.	PERSPEKTIVA PËR TË ARDHMEN	29
H.	RREZIQET E TË ARDHMES SË KORPORATËS	29
I.	KALENDARI FINANCIAR	31
VI.	Shtojca	32
A.	STATUTI I TK-SË	32
B.	PASQYRAT FINANCIARE PRELIMINARE PËR VITIN 2023	32
C.	SPONSORIZIMET DHE DONACIONET	32
D.	RAPORTIMET SIPAS LIGJIT MBI NDËRMARRJET PUBLIKE	33
i.	Pasqyrat e strukturës organizative	34
ii.	Shqyrtimi i performancës afariste dhe financiare gjatë vitit 2023	38
iii.	Përbledhje e të gjitha procedurave gjyqësore ose të arbitrazhit, të pambaruara ose të kërcënua, ose që mund të përfshijnë korporatën	39
iv.	Transaksionet e konsiderueshme që përfshijnë NP ose njësitë e saj ndihmëse	41
v.	Sugjerime dhe propozime për ndryshime të cilat me arsyen pritet që ta rrisin performancën e korporatës	45
vi.	Performance e sistemeve telekomunikuese	46

I. Lista e Tabelave

Tabela 1. Regjistri i Njoftimit të Ndërmarrjeve të Autorizuara nga ARKEP për Ofrimin e Rrjetave dhe/ose Shërbimeve Publike të Komunikimeve Elektronike	17
Tabela 2. Numrat aktiv të Vala	21
Tabela 3. Sistemi i integruar për monitorimin e platformave të rrjetit dhe siguri kibernetike	Error!
Bookmark not defined.	
Tabela 4. Të punësuarit e nxjerrë nga sistemi në fund të çdo muajji	36

Shkurtesat

- TK - Telekomi i Kosovës
- AB- Auditori i Brendshëm
- ZKA- Zyra kombëtare e Auditimit
- QoS – Kualiteti i shërbimeve (Quality of Services)
- SB – Stacion Bazë (apo siç është përdorur deri tani BTS-Base transmission station)
- NGN – (NextGenerationNetwork) = rrjetat e gjeneratës së re
- EWSD - Electronic Worldwide Switch Digital
- ITU - International Telecommunication Union (ITU) – Unioni Ndërkombëtar i Telekomunikacionit
- ETS- Emergency Telecommunications Service - Shërbimi Emergjent i Telekomunikacionit
- IPTV- Internet Protocol Television -Televizion përmes protokollit të internetit
- POSTPAID- Konsumatorët me faturë mujore
- PREPAID - Konsumatorët me parapagim
- SMS- Shërbimi i mesazheve me tekst
- ARPU- Të ardhurat mesatare për konsumator
- OTT- Over the Top (aplikacione për biseda, chat dhe mediatike online)
- OE- Operator Ekonomik
- LTE- Long Term Evolution – Standard i evolucionit afatgjatë
- IP- Internet Protocol (Protokolli i Internetit)
- MTI- Telekomi i Monakos, pjesa ndërkombëtare
- CC377 e MCC212.
- PSO- Procedura Standarde e Operimit
- 2G- Gjenerata e dytë e komunikimeve mobile
- 3G – Gjenerata e tretë e komunikimeve mobile
- 4G- Gjenerata e katërt e komunikimeve mobile
- 4G+ - Gjenerata e katërt e avancuar e komunikimeve mobile
- 5G – Gjenerata e pestë e komunikimeve mobile
- GSM - Global System For Mobile Communication (Sistemi Global për Komunikim Mobil)
- GPRS-GENERAL PACKET RADIO SERVICE) = Platforma për shërbimin e Internetit
- EBITDA- Earning Before Interest Tax Depreciation and Amortization/ Fitimi para tatimit, zhvlerësimit dhe amortizimit
- CAPEX- Investimet Kapitale
- ISP - Internet Service Provider (Ofrues i shërbimit të internetit)
- ATK- Administrata Tatimore e Kosovës

II. PROFILI I SHKURTËR I KOMPANIË



Telekomi i Kosovës (TK) është kompani publike që operon sipas Legjislacionit të Republikës së Kosovës. Telekomi i Kosovës Sh.A është ofruesi më i rëndësishëm i shërbimeve dhe produkteve në fushën e komunikimeve elektronike në vend.

Synimi i përhershëm i Telekomit të Kosovës është që të jetë lider i zhvillimit të industrisë së komunikimeve elektronike në vend, duke ofruar një gamë të gjerë të produkteve dhe shërbimeve mobile dhe fikse, dhe përmbajtje televizive me qëllim të përbushjes së nevojave dhe kërkesave të konsumatorëve të vet. Qëndrueshmëria financiare është qëllimi kryesor i planifikuar për periudhën 2024-2026, që do të arrihet përmes zhvillimit të aktiviteteve, të cilat janë në përputhje me objektivat strategjike të përcaktuara dhe kërkesat e konsumatorëve rreth produkteve dhe shërbimeve që ofron Telekomi i Kosovës.

Si shtyllë tejet e rëndësishme dhe e përgjegjshme e komunikimeve elektronike në Kosovë, jemi të angazhuar që zhvillohem më tej, në një kompani e cila ofron mundësinë e shkëmbimit të të dhënave (Internet) me një shpejtësi të lartë përmes shfrytëzimit të teknologjive më të reja.

Në kohën e globalizmit e të zhvillimeve tejet të hovshme teknologjike si dhe rritjen e kërkesave të konsumatorëve për shërbime telekomunikuese, Telekomi i Kosovës përmes teknologjive me të reja ofron produkte dhe shërbime inovatore e të nevojshme për konsumatorët e vet.

III. RAPORTI I KRYESUESIT TË BORDIT TË DREJTORËVE



Inderuar Aksionar,

Kam nderin të ju prezantoj raportin vjetor të Telekomit të Kosovës Sh.A për vitin fiskal i cili ka përfunduar me datën 31.12.2023.

Si Kryetar i Bordit të Drejtorëve, kam kënaqësinë të raportoj se TK Sh.A gjatë kësaj periudhe ka arritur t'i realizojë objektivat kryesore, duke demonstruar përshtatshmëri në një mjeshtë biznesi dinamik dhe sfidues. Gjithashtu, në të njëjtën kohë është ballafaquar me kërcenime ligjore të trashëguara nga e kaluara.

Bordi i Drejtorëve të Telekomit të Kosovës, i emëruar me 21.04.2021, duke ushtruar funksionet në përputhje me Ligjin nr.03/L-087 për Ndërmarrje Publike, sikurse është plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr.04/L-111 dhe Ligjin nr.05/L-009 (tutje referuar Ligjit për ndërmarrje publike), ka ushtruar detyrat dhe përgjegjësitë e tij në përputhje me standartet me të larta profesionale të kujdesit për zhvillimin e Telekomit të Kosovës Sh.A dhe të zbatimit të detyrave fiduciare të qeverisjes korporative.

Bordi i Drejtorëve ka shqyrtuar dhe aprovuar rekomandimet (të arsyeshme) të Komisionit për Ristrukturim dhe Komisionit për Përshkrimin e vendeve të punës dhe gradime, për ndryshimet dhe plotësimet eventuale në skemën e aprovuar.

Është përkrahur dhe udhëzuar Menaxhmenti Ekzekutiv që në bashkëpunim me ekspertët e jashtëm ligjor të ndërmarrin të gjitha veprimet e rregullta procedurale lidhur me përfaqësimin dhe mbrojtjen e Telekomit në Gjykatat ndërkombëtare të arbitrazhit.

Industria e telekomunikacionit është duke evoluar me shpejtësi , kështu që edhe TK Sh.A ka qenë proaktive në përqafimin e inovacionit dhe teknologjisë se re, për të qëndruar në hap me këto zhvillime teknologjike. TK Sh.A pas nënshkrimit të kontratës me OE Ericsson Nikolla Tesla ka filluar ndërrimin e pajisjeve teknologjike të vjetruara dhe pa përkrahje nga prodhuesit paraprak, duke instaluar/zëvendësuar të njëjtat me pajisje moderne të teknologjisë 4G+ (5G ready), me qëllim të rritjes së mbulueshmërisë si dhe të ofrimit të shërbimeve/produkteve më të avancuara. Ky projekt ka forcuar pozicionin tonë në treg si dhe besoj fuqishëm se do t'i mundësojë TK Sh.A rritje të qëndrueshme në vitet e ardhshme.

Gjendja financiare dhe teknologjike e Telekomit të Kosovës vazhdon të mbetet sfiduese, megjithatë Bordi i Drejtoreve dhe Menaxhmenti kanë vazhduar me përkushtim për t'i adresuar dhe menaxhuar të gjitha aktivitetet e nevojshme dhe emergjente të paraqitura.

TK Sh.A ka arritur një performancë solide financiare gjatë vitit 2023. Të ardhurat tona kanë shënuar rritje prej 8.61% krahasuar me vitin fiskal paraprak, duke arritur në një total prej 57.4 mil.

Përkrahja e menaxhmentit ekzekutiv për çështjet financiare dhe efikasitetit operacional, ka mundësuar që të mbajmë një fitim neto prej 7.9 mil.

Kënaqshmëria e klientit është fokusi ynë primar dhe mbetet një gur themeli i filozofisë së biznesit tonë. Jemi krenarë të raportojmë se reagimet e klientëve me ofrimin e shërbimeve/produkteve të avancuara si dhe përmirësimin e cilësisë se rrjetit kanë qenë pozitive dhe atë falë investimeve të TK Sh.A, të cilat kane kontribuar në rritjen e besnikërisë dhe besimit të klientit në NP TK Sh.A. Kjo vërehet sidomos në rajonet ku ka filluar zëvendësimi i pajisjeve të vjetra të rrjetit me ato të reja.

TK Sh.A e ka parasysh rëndësinë e të qenit një korporatë e përgjegjshme. Iniciativat tona të përgjegjësisë sociale të korporatës kanë vazhduar të kenë një ndikim pozitiv në komunitetet të cilave u shërbejmë. Aktivitetet e TK Sh.A në lidhje me përgjegjësitë sociale të korporatës ishin: "*Organizimi i aktiviteteve për Muajin e Rinisë në koordinim me Ministrinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit, "Shënimi i Muajit të Ndërgjegjësimit për Kancerin e Gjirit", "VALA për fëmijët"*". Ne mbetemi të përkushtuar ndaj qëndrueshmërisë dhe praktikave etike të biznesit, duke i përafruar përpjekjet tona me qëllimet për të krijuar një të ardhme më të mirë për të gjithë.

Shpreh mirënjojen time të përzemërt për menaxhmentin ekzekutiv, punonjësit tanë të përkushtuar, klientët besnikë si dhe mbështetjen e vazhdueshme të aksionarit për të kontribuar në rimëkëmbjen e TK Sh.A. Së bashku, ne jemi duke ndërtuar një kompani që përqafon inovacionin, vlerëson integritetin dhe përpinqet përsosmëri në të gjitha aspektet e biznesit tonë.

Kam besim se TK Sh.A do të vazhdojë rrugëtimin drejt rimëkëmbjes së plotë dhe të vazhdojë me sukseset e saj edhe në të ardhmen, si dhe mbetem me bindje të plotë se do të japë vlerë për të gjitha palët e interesit.

Sinqerisht,

Shpëtim Dobra – Kryesues i Bordit të Drejtoreve të TK Sh.A.

a. Aktivitetet dhe performanca e ndërmarrjes së TK-së.

Megjithëse Telekomi i Kosovës Sh.A ka arritur përmirësime të dukshme sa i përket gjendjes së përgjithshme financiare dhe asaj teknologjike në vitin fiskal 2023, këto dy fusha ende mbesin sfiduese për korporatën tonë.

TK Sh.A ka arritur targetet e specifikuara në planin e biznesit për vitin fiskal 2023 dhe ka tejkaluar ato duke realizuar $\approx 102\%$ të të hyrave të planifikuara, përkatesisht janë realizuar 57.4 mil.€ nga 56.3 mil.€ sa ishin planifikuar. Ndërsa krahasuar me vitin e kaluar, të hyrat aktuale të vitiit 2023 janë realizuar në masën 108.61% nga 52.8 mil. € sa ishin realizuar në vitin 2022.

Për sa u përket shpenzimeve në përgjithësi, ato janë më të ulëta se sa shpenzimet e planifikuara për vitin 2023, për rreth 13% ose për 7,516k € më pak, ndërsa krahasuar me vitin 2022, shpenzimet e përgjithshme janë për 12.40% më të ulëta ose për 7,006k euro.

Gjithashtu, Telekomi ka arritur të ketë vlerësim më të mirë nga Zyra Kombëtare e Auditimit, ku në krahasim me vitin paraprak (opinioni i kundërt), ka marrë "opinion të kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore".

Infrastruktura e Telekomit të Kosovës lidhur me shërbimet mobile, ofron mbulueshmëri në bazë të popullsisë në nivel vendi prej rreth 99.5%, ndërsa mbulueshmëri të territorit mbi 94%. Shërbimet dhe produktet mobile dhe ato fikse, që ofrohen nga infrastruktura e integruar telekomunikuese e TK Sh.A, kanë vazhduar të përmbushin kriteret e rekomanduara me standartet ndërkombëtare. Edhe pse tregu i shërbimeve/produkteve të rrjetit fiks dhe shërbimeve të internetit, duke përfshirë edhe përbajtjen televizive (relativisht të varfër) ishte i disfavorshëm për TK Sh.A në vitin fiskal 2023, besojmë se me vazhdimin e investimeve në zgjerimin e rrjetit optik dhe në platforma teknologjike të avancuara si dhe kontrata e lidhur me DigitAlb do t'i sjellin përmirësim në pozicionimin e TK Sh.A në këto segmente të tregut kosovar.

Viti 2023 ka shënuar fillimin e implementimit të projekteve kapitale potenciale profitabile, sidomos të atyre teknologjike për zhvillimin dhe zgjerimin e infrastrukturës në drejtim të një rrjete të integruar telekomunikuese, zëvendësimin e 120 SB-ve të vjetra me ato të reja, konform kontratës me OE Ericsson, dhe atë në rajonin e Ferizajit dhe Gjilanit. SB-të e vjetra ALU janë zhvendosur dhe riintegrar në pjesë tjera të rrjetit, duke shtuar në këtë mënyrë kapacitetet dhe duke përmirësuar kualitetin në ato zona. Ka filluar modernizimi i rrjetit qendor mobil, duke përfshirë ndërrimet e nevojshme për kodin e Kosovës. Gjithashtu ka filluar aktivizimi i përdoruesve për shërbimet të cilat i ofron platforma OTT.

Pas aprovimit të strukturës se re të TK Sh.A dhe dispozitave ligjore përcjellëse të cilat e rregullojnë procesin e ristrukturimit, si dhe me plotësim/ndryshimet e arsyeshme, ka filluar dhe është në proces implementimi i strukturës se re organizative, e cila parashihet të përfundojë gjatë vitiit 2024.

b. Informacione lidhur me kapitalin dhe dividentën


Gjatë vitit 2023, dividenta prej TK-së për Aksionarin nuk është deklaruar. Po ashtu, nuk ka pasur kërkesë nga Aksionari për tërheqje të dividentëve, duke pasur parasysh situatën e performancës financiare të kompanisë gjatë periudhës raportuese dhe nevojës për investime.

Sa i përket kapitalit, TK Sh.A e përmbylli vitin 2023 me detyrime të zvogëluara dukshëm krahasuar me vitin paraprak. Aktualisht të gjitha obligimet e krijuara rrjedhëse paguhen brenda afatit të paraparë, përfshirë këtu edhe obligimet tatimore.

Duke pasur parasysh nevojën për investime të vazhdueshme teknologjike, gjatë këtij viti, Telekomi ka pranuar mbështetje financiare në formë të kredisë për implementimin e projekteve më prioritare.

c. Të dhënat për drejtorët joekzekutiv

Struktura paraqet emrat e drejtorëve joekzekutiv, zyrtarin kryesor të korporatës dhe sekretarin e korporatës/ këshilltar i përgjithshëm i korporatës.



Bordi i Drejtorëve i TK Sh.A i emëruar me Vendim të Qeverisë nr. 02/08 më datë: 21.04.2021

Kompensimi i anëtarëve të bordeve të Ndërmarrjeve Publike Qendrore (në këtë rast Telekomi Kosovës Sh.A) bëhet sipas Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, nr.07/81, datë: 23.03.2016.

Numri i takimeve të bordit gjatë vitit dhe numri i pjesëmarrjes së drejtorëve në takimet e BtD

Takimet e bordit	Numri i takimeve	Numri i pjesëmarrjes së drejtorëve në takime të bordit
Takimet e rregullta të Bordit të Drejtorëve	16	<ul style="list-style-type: none"> Kryesuesi 5 Drejtorët e Bordit Kryeshefja Ekzekutive dhe Këshilltar i Përgjithshëm/ Sekretari i Korporatës

Komititetet e bordit, përbërja e tyre dhe numri i takimeve të mbajtura

Komiteti i Auditimit	12	<ul style="list-style-type: none"> Sajmie Thaçi, Kryesuese Mimoza Vila, Anëtar Agim Muçaj, Anëtar Selvete Xhigoli, UD Auditore e Brendshme Shekip Fazliu, Këshilltar i Përgjithshëm/ Sekretar i Korporatës Kujtim Saraçi, Auditor i Brendshëm¹
----------------------	----	---

¹ Me vendimin e Komisionit të Auditimit, me nr. prot.01-2855/23, të datës 24.07.2023, në pozitën Zyrtar i Auditimit të Brendshëm sipas konkursit të jashtëm të rishpallur me datën 17.05.2023, është përgjedhur z. Kujtim Saraçi.

IV. FJALA HYRËSE E KRYESHEFES EKZEKUTIVE TË TELEKOMIT TË KOSOVËS

VITI I NGRITJES: OPERIMI ME FITIM DHE MODERNIZIMI I RRJETIT MOBIL DHE FIKS



Përderisa edhe viti 2022 ishte vit i stabilizimit, një vit i suksesshëm për shkak se arritëm të ndalim dhe stabilizojmë rënien e mëtejme të TK në të gjithë parametrat e matshëm, dhe arritëm ta konceptojmë dhe normojmë procesin e ristrukturimit, viti 2023 ishte viti i ngritjes në të gjitha fushat, vit i operimit pozitiv financiar, që nuk erdhi vetëm si rezultat i kursimeve, por edhe i ngritjes së biznesit, rritjes së të hyrave si dhe organizimit më të mirë të punës.

Duke përbledhur të arriturat dhe sfidat e vitit 2023, kemi kënaqësinë të raportojmë për një kompani që aktualisht është duke operuar me fitim, për herë të parë që nga viti 2015, që është indikacion i qartë se me vizion, punë, transparencë, përkushtim, guxim dhe durim edhe një ndërmarrje publike mund të operojë me sukses në kushtet e konkurrencës.

Shpenzimet operative në nivel të kompanisë janë reduktuar ndjeshëm, duke u kujdesur maksimalisht për menaxhimin e duhur me paranë publike, duke shlyer me kohë të gjitha obligimet rrjedhëse të kompanisë në afatet e caktuara për pagesë. Fitimin e gjeneruar jemi duke e kthyer në investime teknologjike për modernizim të rrjetit mobil, rrjetit fiks dhe siguri të rrjetit.

Kemi pasur përmirësim të opinionit të dhënë nga Zyra Kombëtare e Auditimit – nga opioni i kundërt në opinion të kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore.

Në vazhdimësi po punojmë për të ngritur kulturën dhe përgjegjësinë korporative. Fjalët kyçe të rimëkëmbjes së kompanisë janë ligjshmëria dhe transparenca. Raportojmë saktë para publikut, Bordit të Drejtorëve, Aksionarit, të gjitha agjencive shtetërore si dhe mediave, duke konsoliduar një komunikim të jashtëm dhe të brendshëm të përshtatur me zhvillimin e hovshëm të teknologjisë dhe mediave, posaçërisht atyre sociale.

Sinqerisht,

Burbuqe Hana - Kryeshefe Ekzekutive e TK Sh.A

V. RAPORTI I KRYESHEFES EKZEKUTIVE

Viti 2023 ishte vit i modernizimit të infrastrukturës dhe teknologjisë për shërbimet e rrjetit mobil dhe fiks/internetit dhe përmbajtjes televizive, duke trasuar rrugën që viti 2024 të jetë viti më i rëndësishëm për përmbylljen e procesit të konsolidimit përfundimtar të Telekomit të Kosovës, shndërrimit në një kompani publike moderne, konkurrente në tregun e rrjetit mobil dhe me perspektivën e qartë që në një të ardhme jo të largët të jetë lidere në tërë industrinë e telekomunikacionit.

Gjatë gjithë kohës jemi duke punuar në drejtim të përmirësimit të vazhdueshëm të kërkesave dhe përvojës së konsumatorëve si dhe të rritjes së besimit të të gjitha palëve të interesit.

Ky ishte vit i fillimit të implementimit të strukturës së re organizative dhe proceseve të reja të punës, vit i konsolidimit të drejtoreve të reja dhe i përzgjedhjes së drejtoreve të rinj, i cili u pasua me përzgjedhjen e menaxhmentit sipas strukturës së re organizative për të vazhduar tutje, gjithmonë në harmoni me ligjin dhe sipas parimit të profesionalizmit, konkurrencës së brendshme dhe transparencës maksimale.

Gjatë këtij viti jemi përballur suksesshëm dhe vazhdojmë të përballemi ende me sfida, si rezultat i pasojave negative të kontratave të dëmshme nga e kaluara. Në këto aktivitete kemi angazhuar të gjitha kapacitetet profesionale ligjore në dispozicion për të zhvilluar një strategji efektive, identifikimin e opsiioneve ligjore dhe dokumentimin e të gjitha detajeve relevante, si hapa për të mbrojtur interesat e kompanisë dhe për të gjetur zgjidhje të drejtë, duke ndërmarrë të gjitha veprimet dhe duke shfrytëzuar të gjitha mundësitet që na i ofron ligji. Duke u përballur me trashëgiminë e keqe nga e kaluara, në formën e borxheve dhe kontratave të dëmshme, edhe në vitin 2024 do të vazhdojmë të punojmë fuqishëm që beteja jonë ligjore të jetë kontributi i TK në kthimin e ligjshmërisë dhe transparencës në biznesin e ndërmarrjes publike, në një kompani ku Qeveria e Republikës së Kosovës është pronare e 100% të aksioneve dhe e cila është në shërbim të publikut 24/7.

Në vijim të këtij raporti, janë ofruar informata për:

- a) ngjarjet kryesore të vtit,
- b) pasqyrën e tregut të telekomunikimeve në Kosovë,
- c) performancën operative dhe rezultatet e indikatorëve kyç të performancës,
- d) performancën financiare,
- e) progresin me planin e biznesit,
- f) shpenzimet kapitale dhe projektet,
- g) perspektivën për të ardhmen,
- h) rreziqet e të ardhmes,
- i) kalendarin financier.

a. Ngjarjet kryesore të vitit

- Si aktivitet me rëndësi gjatë 2023 janë përgatitjet e dokumentacionit teknik për iniciimin e projekteve të rëndësise së veçantë (si në rrjetin mobil ashtu edhe atë fiks) për procedura të prokurimit publik. Të gjitha specifikimet teknike janë realizuar me angazhim të ekspertizës së brendshme profesionale teknike, duke kursyer kështu pagesa për konsulenca të jashtme.
- Nga aspekti i marketingut dhe shitjes kemi pasur rezultate në tri drejtime: 1. Përmirësimin e produkteve ekzistuese me çmime dhe përmbajtje konkuruese dhe krijimin e produkteve të reja krahas kërkesave të tregut, 2. Shtimin e kanaleve të shitjes dhe përpjekjeve për rritje të shitjeve – krahas uljes së kostove (provizioneve) të shitjes, si dhe 3. Përmirësim në kujdes për konsumatorë.
- Po ashtu, për t'u evidentuar është edhe fillimi i implementimit të ristrukturimit të kompanisë. Ristrukturimi i kompanisë është konsideruar i domosdoshëm sepse synon të eliminojë të gjeturat dhe parregullsitë e shumta të shtresuara ndër vite, duke përcaktuar një strukturë të qartë dhe funksionale organizative me fushëveprimtari të saktësuara për çdo njësi organizative, si bazë për përcaktimin, përshkrimin dhe vlerësimin e të gjitha vendeve të punës në kompani.

Arritje tjera me rëndësi:

- Përshtatja e produkteve ekzistuese dhe krijimi i produkteve të reja sipas kërkesave të konsumatorëve:
- Për konsumatorët e profitit prepaid është krijuar pako NewSIM me përmbajtje dhe çmim të ri e cila ka qenë dhe vazhdon të jetë shumë e shitur, duke rritur të hyrat për 84.40% dhe duke ruajtur bazën e konsumatorëve.
- Optimizimi i resurseve përmes fshirjes manuale të numrave ICC Deaktiv ka pasur efekt pozitiv, duke siguruar 854,603 €uro nga rikrijimi i tyre.
- Gjatë tërë vitit ka vazhduar shitja në nivelet më të larta të pakove Prepaid: 4,386,769 pako (rritje për 4.07%) si dhe të hyra nga shitjet: 25,693,807 €uro (rritje për 7.28%).
- Promocioni i pakos "Fol L" ka ndikuar në rritje të theksuar prej 99.20% duke mundësuar edhe rritjen e ARPU-së.




Fig. 1 Shitia e pakos 'FOL L' dhe të hyrat ndër vite

- Për klientët postpaid të shërbimeve mobile janë krijuar pako të personalizuara varësisht nga kërkesat e bizneseve, ndërsa për shërbimet fiksë përvëç bartjes së klientëve ekzistues në pakot me kapacitete me të larta të internetit, janë bërë përgatitjet për modifikim të pakove ekzistuese që ofrohen përmes platformës IPTV dhe krijimi i pakove të reja atraktive që do të lansohen në janar 2024 me teknologjinë e re televizive (OTT) e pasuar me përmbajtje shtesë të platformës

DigitAlb. Përveç përmirësimit të përvojës së konsumatorëve, këto do të mundësojnë rritje të ndjeshme të të hyrave për Telekomin e Kosovës.

- Pako të reja me çmime të volitshme dhe përbajtë të favorshme për përdorim edhe në Roaming (WB) njëjtë si në Kosovë, si dhe pako tjera për zonën EU. Kjo e shoqëruar me promociion përmes rrjeteve sociale, ka ndikuar në rritje prej 4.51% e të hyrave.
- Shitjet e "Sim Diaspora" në vitin 2023 me rritje 25% krahasuar me shitjet në 2022

Kampanja e suksesshme "SIM Diaspora" e vitit 2022 ka vazhduar me sukses të shtuar edhe në vitin 2023

- **Komunikimi dhe marketingu** – aktivitetet e vazhdueshme të marketingut me kosto minimale dhe implementimi i formave alternative promovuese (si marketingu digital) kanë ndihmuar në përmirësimin e perceptimit të brendit në treg, duke rritur reputacionin dhe besueshmërinë e kompanisë te konsumatorët. Ndër to është pjesëmarrja në projekte promovuese me karakter të ndërgjegjësimit social siç janë:

- Organizimi i aktiviteteve për Muajin e Rinisë në koordinim me Ministrinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit - Muaji i Rinisë shënohet me datën 12 gusht të çdo viti. Këtë vit, me kërkesë të Ministrisë se Linjës dhe MKRS janë zhvilluar aktivitete rinore, kuize, talent show, photobooth dhe janë ndarë shpërblime simbolike me program të planifikuar 3 ditor nga stafi i TK.
- "Shënimi i Muajit të Kancerit të Gjirit" - Në një akt simbolik të vetëdijesimit, me rastin e Ndërgjegjësimit për Kancerin e Gjirit, është organizuar vizita e personelit nga gratë e TK në Klinikën Onkologjike, në mbështetje dhe solidarizim me gratë e prekura me kancerin e gjirit, si pjesë e përgjegjësisë sociale të kompanisë, me qëllim të krijimit të përshtypjes pozitive për brendin.
- "VALA për fëmijët" - Në shenjë mbështetjeje për fëmijët e hospitalizuar, një grup i personelit të TK kanë vizituar repartin e Hematologjisë të Klinikës së Pediatrisë - QKUK, në kuadër të përgjegjësisë sociale të kompanisë, me ç' rast janë bërë dhurata për fëmijët me pjesëmarrje të maskotave për argëtim.

- Janë krijuar dy logo/brende të produkteve/shërbimeve të Vala-Telekomi i Kosovës duke pasuar dhe fuqizuar brendin e Vala-Telekomi i Kosovës në treg:

- Logo/brendi – Vala Jone
- Logo/brendi – TV Vala

- **Brendimi dhe ribrendimi i pikave shitëse** - Procesi i brendimit ka përfshirë një vlerësim të hollësishëm të se cilës pikë, duke identifikuar fushat potenciale për përmirësim dhe hartimin e një plani të detajuar për ribrendimin e tyre, me qëllim që të jemi sa më reprezentativ dhe të krijojmë përshtypje pozitive për brendin. Sa i përket ribrendimit është bërë vlerësimi i pikave të shitjes dhe kujdesit të Telekomit të Kosovës dhe Postës së Kosovës ku punon personeli i Telekomit. Planifikim ky që synon të realizohet gjatë viteve në vijim.

- **Hapja e pikave të reja shitëse dhe riorganizimi i pikave ekzistuese** – gjatë vitit 2023 disa pika me qira më të larta janë zhvendosur në pika të reja me kushte më të favorshme. Njëkohësisht, krahas kërkesës së tregut për prezencë në lokacione me frekuentim më të lartë, janë hapur tri pika të reja shitëse.

- Krijimi dhe lansimi i aplikacionit "Vala Jone" – si kanal i ri i shitjes dhe i (vet)kujdesit për konsumatorë, deri në fund të vitit me rreth 100k përdorues.
 - Përmirësimi i përvojës së konsumatorit - janë bërë riorganizime të proceseve ekzistuese në të gjitha pikat e kontaktit me konsumatorë duke përmirësuar përvojen e përgjithshme të kujdesit për konsumatorë. Përveç kontaktit të parë në pika shitëse dhe qendër të thirrjeve tani bëhet pranimi i kërkesave/ankesave për çdo shërbim edhe përmes e-shitjes dhe e-kujdesit, gjë që ka ndikuar në ngritjen e besueshmërisë së klientëve në shërbimet e Telekomit dhe përkushtimit të kompanisë ndaj tyre. Këto aktivitete kanë rezultuar edhe në:
 - Reduktimin e kohës së pritjes për klientët që thërrasin Qendrën tonë të Thirrjeve nga 53 sekonda në 45 sekonda.
 - Rritja e numrit të zgjidhjeve të ankesave / kërkesave të konsumatorëve që në thirrjen e parë (first call resolution) në 86%.
 - Rritja e të hyrave – gjatë vitit paraprak ka pasur rritje të të hyrave në përgjithësi pothuajse në të gjitha kategoritë, gjë që ka mundësuar edhe arritjen e Planit të Biznesit në 99.24%
 - Rritja e të hyrave nga shitjet e numrave dhe pakove për shërbimet mobile për 6.45% krahasuar me vitin paraprak.
 - Të hyrat nga shitjet e shërbimeve **fikse** nga rënia -11.22% (në vitin 2021) ka rritje në 0.40% në vitin 2023.
 - Rritja e ARPUsë për klientët e shërbimeve **mobile** mbi 4.5%.
 - Rritja e ARPUsë për klientët e shërbimeve **fikse** mbi 4.4%.
 - Hulumtimi i Kënaqshmërisë së Konsumatorëve – gjatë vitit 2023 janë realizuar dy hulumtime për kënaqshmërinë e konsumatorëve me shërbimet tona të cilat janë realizuar me parametra të njejtë sikurse në hulumtimet e vitit paraprak (2022).

Analiza krahasuese tregon për rritje të nivelit të kënaqshmërisë së konsumatorëve, sidomos në raportin e fundit. Ky rezultat është edhe reflektim i të gjithë faktorëve të specifikuar që ndërlidhen me përmirësimin e përvojës së konsumatorëve e që ndër të tjera janë: përmirësimi i performancës së stafit, përmirësimi i produkteve dhe formave dhe kanaleve të reja të shërbimit.

Në kuadër të komponentës ligjore janë ndërmarrë veprime për konsolidimin e departamentit dhe njësive përkatëse me qëllim të përfaqësimit dhe mbrojtjes ligjore në mënyrë efikase dhe të duhur. Njëherësh janë ndërmarrë edhe disa veprime ligjore, janë iniciuar padi në gjykata të rasteve të kontratave që përmbajnë problematika të zbatimit të dispozitave të caktuara. Për detaje më të hollësishme ju lutem referohuni në shtojcën d. iii. të këtij dokumenti.

Përveç aktivitetave të rregullta operative, gjatë vitit 2023 është punuar në modifikimin, hartimin, ndryshimin dhe plotësimin e rregulloreve interne të kompanisë, sipas udhëzimeve dhe rekomandimeve të aprovuara edhe nga Bordi i Drejtorëve të TK-së. Shih shtojcën i - Rregulloret Dhe Draft Rregulloret.

Aktivitetet në Qendrën për Trajnim dhe Zhvillim (QTZH). Qendra për Trajnim dhe Zhvillim përgjatë vitit 2023 është përkushtuar në punë dhe angazhime të vazhdueshme, duke u përpjekur që planifikimi dhe realizimi i trajnimeve të bëhet sipas kërkesave të pranuara nga departamentet tjera të Telekomit të Kosovës dhe planeve të hartuara nga vetë shtyllat e QTZH-së. Përgjatë 12 muajve të vitit 2023, janë arritur këto rezultate:

5 shtyllat e Qendrës për Trajnim dhe Zhvillim kanë ofruar trajnime për 1038 punonjës, dhe janë mbajtur gjithsej 1210.66 ditë trajnimi.

Në kuadër të Departamentit të Logistikës, janë përgjigjur pozitivisht në të gjitha kërkesat/aktivitet e planikuara dhe të paplanikuara nga Departamentet, regjionet, komunat, objektet dhe pikat shitëse. Gjithashtu është vepruar edhe në bazë të nevojave dhe urgjencave, si në aspektin e sigurisë, mirëmbajtjes, transportit, energjetikës, ngrohjes dhe klimatizimit, kontrollit, transportit të parasë CIT etj.

b. Pasqyrat e tregut të telekomunikimeve në Kosovë

Industria e telekomunikacionit dhe shërbimet/produktet e saj po ndryshojnë vazhdimisht në mbarë botën për shkak të inovacioneve në teknologji, shërbime, industri të tjera dhe aktivitet njerëzor, të cilat përfshijnë digjitalizimin. Ky transformim, edhe pse më i ngadalshëm, po ndodh edhe në vendin tonë, i nxitur nga teknologjia, sjellja e konsumatorëve dhe digjitalizimi i më shumë shërbimeve administrative dhe financiare, si dhe ndryshimet përkatëse në legjislacion dhe rregullore për të harmonizuar kuadrin ligjor me vendet e BE-së dhe për të balancuar tregun. Ofruesit e shërbimeve të komunikimit (telekomunikacionit) (OSHC) duhet të përshtaten vazhdimisht me nevojat e tregut dhe të ofrojnë shërbime dhe produkte inovative. Në këtë këndvështrim, Ofruesit e Shërbimeve të Komunikimit (*ang: Communication Service Provider CSP*) ndryshojnë dhe zgjerojnë vazhdimisht produktet, shërbimet dhe modelet e tyre të biznesit për të përm bushur kërkesat e tregut duke investuar në teknologji, e cila përmirëson cilësinë e shërbimit dhe inovacionin dhe i bën shërbimet e komunikimit më lehtë të qasshme.

Sektori i Telekomunikacionit në Kosovë ka vazhduar të ketë një zhvillim të qëndrueshëm dhe gjatë vitit 2023, duke shënuar një total në qarkullim prej rreth 169 milionë euro, e që paraqet një rritje prej afro 12% karshi vitit 2022. Kjo rritje prej 12%, apo afro 21 milionë euro, është evidentuar në dy kategori shërbimesh: në të hyrat e shërbimeve mobile (rreth 13 milionë ose 14% më shumë se sa në vitin e kaluar) dhe në të hyrat nga shërbimi i internetit, me ç'rast të hyrat e përgjithshme nga ky lloj shërbimi janë rritur prej më shumë se 8 milionë (ose 17%) krahasuar me vitin 2022. Analiza e indikatorëve tjerë të tregut na bën të kuptojmë se kjo rritje e të hyrave vjen kryesisht si rezultat i rritjes së çmimeve në këto kategori shërbimesh, me ç'rast vetëm në kategorinë e shërbimeve mobile është evidentuar një rritje e ARPU-s prej pak më shumë se 10% karshi vitit 2022.

Vlen të theksohet se i vetmi segment i të hyrave që vazhdon të tregojë rënie (të theksuar) janë të hyrat e rrjetit fiks, ku rënia shkon mbi 35%, karshi vitit 2022. Nga ana tjetër, të dhënat (edhe pse jo të plota nga ARKEP-mungan TM4-2023, dhe me qëllim analize të të gjithë vitit 2023, të dhënat për TM4-2023, janë plotësuar me mesataren e tre tremujorëve të viti 2023, dhe krahasuar me TM4-2022!) tregojnë rritje investimesh (për rreth 50%, karshi vitit paraprak) në sektorin e shërbimeve telekomunikuese në nivel vendi. Ndonëse raportet e ARKEP nuk specifikojnë natyrën e investimeve që bëhet nga operatorët e licencuar, me të drejtë, supozohet se shumica e këtyre investimeve janë në segmentin e shërbimeve telekomunikuese mobile dhe në segmentin e shërbimeve telekomunikuese të internetit fiks. Duke njohur faktin se shërbimet e internetit fiks ofrohen në pako së bashku me përbajtje televizive, është e qartë se shumica e këtyre investimeve shkojnë në përmirësim të infrastrukturës për shërbime fikse dhe shërbime mobile, që mundësojnë këto shërbime dhe që shërbejnë si bazament për të zgjeruar përherë e më shumë gamen e shërbimeve të komunikimit digjital.

Tregu i telekomunikacionit në Kosovë është i rregulluar dhe mbikëqyret nga Autoriteti Rregulator i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP). Aktualisht, sektori i telekomunikimeve mobile dominohet nga Telekomi i Kosovës (Vala) dhe IPKO dhe rreth 95% e tregut mbulohet nga këta dy OShK. Numri i ndërmarrjeve për ofrimin e Rrjetave Publike Mobile është 3 (Telekomi i Kosovës dhe IPKO kanë licencë nationale ndërsa MTS. d.o.o licencë regionale), ndërsa numri i ndërmarrjeve që ofrojnë Shërbime Publike Mobile është 5.

Nga ana tjetër, numri i Ndërmarrjeve të licencuara për ofrim të Rrjetave Publike Fikse është 89, i atyre të Shërbimeve të Internetit 81, i atyre të Shërbimeve të Linjave me Qira 28 dhe i atyre për Shërbime me Vlerë të Shtuar (VAS) 35. Këto të dhëna nga fusha e shërbimeve fikse, flasin për një treg të hapur dhe mjaft konkurruar. Në tabelën vijuese (Tab.1), në mënyrë të përbledhur është dhënë numri i ndërmarrjeve të autorizuara për ofrimin e rrjetave dhe/ose shërbimeve publike të komunikimeve elektronike.

Shërbime me Vlerë të Shtuar (VAS)	35
Shërbime të Internetit	81
Rrjet Publik fiks	89
Shërbime Publike telefonike fikse	14
Shërbime të Linjave me qira	28
Rrjet publik mobil	4
Shërbime publike mobile	6
Rrjet publik me transmetim satelitor	1
Shërbime publike satelitore	1
Numri Totali i Aktiviteteve	256
Numri Total i Ndërmarrjeve	118
Numri i aktiviteteve për ndërmarrje	7

Tabela 1. Regjistri i Njoftimit të Ndërmarrjeve të Autorizuara nga ARKEP për Ofrimin e Rrjetave dhe/ose Shërbimeve Publike të Komunikimeve Elektronike

(burimi-ARKEP: <https://www.arkep-rks.org/desk/inc/media/5bb2062f-75cf-4fc0-ae7b-c5e14605fbef.pdf>)

Kur jemi tek shërbimet e internetit fiks dhe shërbimit të shpërndarjes së përbajtjes televizive, të dhënat janë të mangëta dhe nuk pasqyrojnë gjendjen e plotë në tregun kosovar. Këtu, janë dy komponentë kyç që mungojnë, e që janë:

1. numri i ofruesve të rrjetave publike fikse mund të jetë edhe më i madh se 89 duke ditur faktin se ka një numër ofruesish piratë të cilët veprojnë në nivel lokal ose rajonal e që nuk janë të regjistruar në ARKEP. Në këtë mënyrë, numri i gjithmbarshëm i ofruesve të internetit (edhe përbajtjes televizive) mund të jetë edhe më i madh se 81 (shërbime të internetit)!.
2. situata më e keqe është me "Operatorët" që ofrojnë shërbime telekomunikuese, e që për bosht kanë ofrimin e përbajtjeve televizive. Numri i "operatorëve" që ofrojnë shërbime të përbajtjes televizive, veçmas të atyre që këtë shërbim e ofrojnë bazuar në teknologjinë OTT (ang: Over The Top), është pjesërisht i ditur. "Operatorët" e këtij lloj shërbimi, janë nga katër anët e botës dhe shumëlojshmëria dhe numri i kanaleve TV që ata ofrojnë, është shumë më i madh se ai i regjistruar në Komisionin e Pavarur të Mediave.

I themeluar në vitin 2005, Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) sipas nenit 141 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës përcaktohet organ i pavarur. Në bazë të Ligjit Nr. 04/L-44, KPM-ja licencon transmetuesit publik e privat, përcakton dhe zbaton politikën e transmetimit si dhe rregullon të drejtat, detyrimet si dhe përgjegjësitë e personave fizik dhe juridik të cilët ofrojnë shërbimet mediale audio dhe audiovizuale. Në raportin e publikuar në Janar të 2023 nga KPM-ja, në Kosovë janë gjithsej 35/38² operatorë të licencuar

² Burimi: [Komisioni i Pavarur i Mediave \(kpm-ks.org\)](http://Komisioni i Pavarur i Mediave (kpm-ks.org))

për shpërndarjen e përbajtjes Televizive. Nga ky numër 27 janë kabllorë (përbajtjen TV e shpërndajnë përmes rrjetave kabllore, *(në këtë grup dominojnë ata që shpërndarjen e bëjnë me kabllo koaksiale dhe më pak me fibër optik)*, ndërsa 6 janë të licencuar për IPTV. Numri 35/38 paraqet numrin e përgjithshëm të operatorëve karshi numrit të licencave. Bie fjalë, Telekomi i Kosovës Sh.A është i licencuar për IPTV dhe OTT. Në anën tjetër, po sipas KPM-së, numri i Televizioneve të licencuara përmes operatorëve të shpërndarjes është 114³.

Analiza e tregut sipas shërbimeve mobile, fikse dhe Broadband fiks Tregu i shërbimeve mobile, numri i përdoruesve

Tregu kosovar i telekomunikacionit dominohet nga shërbimet mobile, me një pjesëmarrje vjetore të të hyrave në rreth 117 milionë respektivisht me një proporcion në totalin e tregut prej 69%⁴. Shërbimet mobile, krahas ofrimit të shërbimeve të rrjetit mobil dhe SMS-it, tani e dhjetë vite janë duke ofruar edhe shërbime të internetit të shpejtë, Broadband, 3G dhe 4G (LTE), e së fundi, në zona të caktuara gjeografike, edhe shërbime 5G. Ky treg mund të konsiderohet i ngopur në kuptimin e numrit të përdoruesve dhe në fund të tremujorit të tretë TM3-2023, shënon shifrën prej 1,949,961⁵ përdoruesish, respektivisht me një rritje të kufizuar prej rreth 1.7% karshi vitit të kaluar. Ky numër, karakterizohet me luhatje të konsiderueshme duke shënuar rritje gjatë tremujorëve të tretë të vitit aktual dhe ulje gjatë tremujorit të parë të vitit aktual dhe atij pasues.

Në këtë treg, Telekomi i Kosovës nën brendin Vala, me përpjekje të mëdha, ka arritur të ruajë pjesëmarrjen e vet në treg përkundër mungesës disavjeçare të investimeve. Nëse i referohemi të dhënavë nga ARKEP, gjatë vitit 2021, dhe 2022, të gjithë OShK në Kosovë kishin realizuar investime prej 14.3, respektivisht 22.3, ndërsa vetëm në nëntëmujorin e parë të vitit 2023 investimet tejkalojnë shifrën prej 50⁶ milion eurosh. Në secilin rast (vit) investimet e Telekomit nuk e kapin 50% të totalit të investimeve nga të gjithë OShK-të, pavarësisht faktit të ditur se Telekomi ka shtrirjen infrastrukturore më të madhe në vend. S'do mend që kjo mungesë disavjeçare investimesh ka për pasoj rrreshtimin e operatorëve të shërbimeve mobile, duke e vendosur Valën në pozitën e dytë në treg, si për nga numri i përdoruesve po ashtu edhe nga proporcioni i të hyrave që gjenerohen nga tregu i shërbimeve mobile. Sipas raportit të ARKEP (TM3-2023) pjesëmarrja e Vala për nga numri i përdoruesve është tek 45%, përderisa në të hyra kjo pjesëmarrje është tek 40%. Këto shifra potencojnë edhe njëherë nevojën për investime edhe më të mëdha në fushën e shërbimeve mobile, shërbime këto që përbejnë mbi 85% të të hyrave të përgjithshme për Telekomin e Kosovës. Krahas investimeve, një analizë më e detajuar, e pavarur, mbi kënaqshmërinë e konsumatorëve me shërbimet e Vala, si dhe një analizë e detajuar mbi strukturën dhe moshën e konsumatorëve, do të mund të hidhte më shumë dritë në të gjitha aspekt e biznesit të Vala. Në këtë drejtim, një raport i brendshëm i Telekomit mbi kënaqshmërinë e konsumatorëve, i realizuar gjatë viti 2023, na sjell një varg fakte të interesante të cilat duhet të shërbejnë si bazë për një planifikim më të mirë, pozicionim më të mirë të kompanisë në treg dhe në veçanti një orientim strategjik më të mirë të kompanisë.

Tregu i shërbimeve fikse, numri i përdoruesve

³ Burimi: [Komisioni i Pavarur i Mediave \(kpm-ks.org\)](http://Komisioni i Pavarur i Mediave (kpm-ks.org))

⁴ Përllogaritur si raport mes të hyrave në shërbimet mobile karshi të hyrave të përgjithshme në industri. Burimi: *raportet tremujore nga ARKEP për vitin 2022*.

⁵ Burimi: Raporti tremujor i ARKEP, TM3-2023

⁶ Burimi: Përllogaritur si raport tremujore të ARKEP për vitet 2021 dhe 2022.

Numri i përdoruesve të rrjetit fiks është në rënien e vazhduar nga viti në vit dhe në TM2-2023, nga të dhënat e ARKEP, rezulton se norma e penetrimit të rrjetit fiks në Kosovë është 3.81%. Edhe të hyrat që krijohen nga rrjeti fiks janë në rënien e vazhduar nga viti në vit, duke shënuar një përqindje prej 2.04% karshi totalit të tē hyrave. Nisur nga gjendja aktuale dhe perspektiva e shërbimeve të rrjetit fiks është e pritshme që:

- do të vazhdojë rënia e numrit të konsumatorëve
- do të vazhdojë ulja e tarifave të shërbimeve të rrjetit fiks
- do të vazhdojë ulja e trafikut (on-net dhe off-net) të rrjetit fiks
- do të vazhdojë ulja e tē hyrave nga shërbimi i rrjetit fiks

Tregu i shërbimeve të internetit me qasje fikse, numri i linjave

Tregu kosovar i shërbimeve të internetit me qasje fikse është tregu më konkurruen në rajon dhe më gjërë. Në vitin 2022, Kosova ka shënuar vendbanimin e fundit në të cilin është shtrirë infrastruktura për qasje në internet fiks dhe në këtë mënyrë, vendi ynë, bëhet vendi i parë në rajon ku qasja në internet fiks (brezgjerë) është bërë e mundur në çdo vendbanim të tij⁷. Ky fakt është jashtëzakonisht domethënës, duke marrë parasysh se shërbimi i internetit është shërbim kryesor për çdo ofrues të shërbimeve telekomunikuese fikse apo mobil. Në proporcione të tē hyrave të përgjithshme, të hyrat nga ky lloj shërbim kapin vlerën e rreth 47 milionë eurove në vit, apo rreth 27% të totalit të tē hyrave në industrinë e telekomunikacionit në nivel vendi⁸.

Numri i linjave të internetit me qasje fikse brezgjerë deri në TM3-2023, i raportuar nga 81 operatorët e licencuar sipas ARKEP, shënon shifrën 391,157 linja të internetit. Respektivisht, shkalla e penetrimit të internetit përmes qasjes fikse brezgjerë për ekonomitë familjare është 131.73%, përkatësisht, penetrimi i internetit sipas numrit të banorëve është 21,57%. Brenda çdo viti, kemi luhatje të numrit të gjithmbarshëm të linjave, duke shënuar rritje muajve të pranverë-verës dhe rënien gjatë muajve të vjeshtë-dimrit.

Shikuar nga aspekti komersial, shërbimi Broadband fiks në më shumë se 95% të rasteve dhe nga tē gjithë operatorët e licencuar për këtë shërbim, ofrohet në pakon përbashkët Internet+TV. Në këtë drejtim, duhet theksuar një fakt tjeter të rëndësishëm e që është mungesa e raporteve zyrtare të tē hyrave që krijohen nga shitja (ri-shitja) e kanaleve TV. Bazuar në komunikimet me zyrtarët e ARKEP dhe zyrtarët Telekomit, konfirmohet se në raportet e ARKEP për Ndarkerjen e Tregut sipas operatorëve në shërbimin Broadband fiks dhe në raportin e Ndarkerjes së Tregut sipas tē hyrave nga shërbimet Broadband fiks, nuk përfshihen të hyrat që realizohen nga shërbimi i shpërndarjes (rishitjes) së kanaleve TV. Raporti i tillë mungon edhe në raportet vjetore e tremujore të KPM.

Dimensioni i plotë i një shkalle kaq të lartë të penetrimit të internetit Broadband fiks, nuk kufizohet vetëm në ndarjet e tregut (sipas operatorëve) dhe tē hyrave të drejtpërdrejta që krijohen nga ky shërbim. Duke ditur se interneti përbën "elementin" bazë për çdo lloj shërbimi komunikues në botën e sotme (phone call, SMS, MMS, Video-streaming, video conversation, video gaming, online gaming, live tv watching etj etj), mund tē përfundojmë se, përmes ofrimit të këtij shërbimi (internetit), secili operator (fiks apo mobil) në mënyrë tē drejtpërdrejtë apo tē tërthortë, është konkurrent i secilit operator (fiks apo mobil).

Pjesëmarrja e Telekomit në këtë treg të shërbimeve Broadband fikse është e ulët dhe sillet rreth 7,42%. Kjo përqindje ka pësuar rënien përvite të tēra me radhë dhe është pasojë e dy faktorëve kryesorë:

Një, mungesës së investimeve në rrjetin e qasjes fikse me qëllim tē kalimit të teknologjisë nga rrjetat e bakrit në ato optike, me ç'rast Telekomi do tē ishte në gjendje tē ofronte shpejtësi shumë më të madhe

⁷ [Ngjarja Festive Kosova Connected – KODE Project](#)

⁸ Përllogaritur si raport mes tē hyrave në shërbimet mobile karshi tē hyrave të përgjithshme në industri. Burimi: raportet tremujore nga ARKEP

të internetit krahas asaj që ofrohet sot në rrjetat e bakrit, e cila shpejtësi në standardet e reja të Bashkimit Evropian synohet të jetë 1Gbit/sec në vitin 2025.

Dy, përmbajtja e varfër televizive. Duke e ri-potencuar atë që u tha më lart lidhur me aspektin komersial të ofrimit të shërbimit Broadband fiks, dhe përqindjes së lartë rrëth këtij tregtimi, mund të konkludohet se krahas shpejtësisë së internetit, përmbajtja televizive luan një rol kryq në përcaktimin e konsumatorit për një nga operatorët e shumtë. Arritura e marrëveshjes me DigitAlb, tregon për interesim në rritje të konsumatorëve për këtë lloj shërbimesh. S'do mend që kjo do të pasqyrohet në rritjen e pjesëmarrjes së Telekomit në këtë treg si dhe rritjen e gjithmbarshme të të hyrave gjatë vitit 2024.

c. Pasqyra e performancës operative dhe rezultatet e indikatorëve kyç të performancës

i. Shërbimet mobile

Infrastruktura e Telekomit të Kosovës lidhur me shërbimet mobile, ofron mbulueshmëri në bazë të popullsisë në nivel vendi prej rreth 99.5%, ndërsa mbulueshmëri të territorit mbi 94% nëpërmjet tri teknologjive 2G, 3G dhe LTE/LTE+. Kapacitetet teknike të instaluara për konsumatorët prepaid dhe postpaid janë 1.5 milionë. Infrastruktura teknologjike është GSM/GPRS/EDGE, 3G/HSPA+ dhe 4G/4G+.

Rrjeti Radio është i përberë nga pajisjet e tre prodhuesve, ish Alcatel-Lucent, Nokia, dhe Ericsson NT përmes projektit në implementim. Rrjeti mobil operon me 556 Stacione Bazë (SB) aktive. Prej tyre 413 janë 4G/4G+ (293 në 4G, 120 në 4G+), kurse 116 BS janë 2G/3G dhe 63 vetëm 2G.

Aktualisht, shërbimet mobile të qasjes brezgjerë me teknologjinë 4G/4G+ janë duke u pritur shumë mirë nga konsumatorët tanë, shërbim i cili është shumë më konkurrues në krahasim me operatorët tjerë. Teknologjia e cila është duke u përdorur për këtë shërbim është pjesë e zhvillimeve të fundit teknologjike dhe këto shërbime po ofrohen për bizneset, institucionet e ndryshme dhe konsumatorët individual në Kosovë.

Duke pasur parasysh shpërndarjen aktuale të SB-ve në 2G, 3G dhe 4G/4G+, nevojitet shtim i numrit të SB-ëve në 4G/4G+/5G, në mënyrë që të rritet përqindja e mbulueshmërisë me shërbime brezëgjera mobile si dhe të rritet kualiteti i tyre. Kjo është duke ndodhur me projektin e Modernizimit të Rrjetit. Deri tani janë instaluar 120 SB të Ericsson NT në teknologjitë 2G/4G+.

Numri i konsumatorëve aktiv në fund të TM4 të vitit 2023 është 843,292, duke përfshirë edhe konsumatorët roaming.

Numri maksimal i konsumatorëve aktiv duke përfshirë edhe inbound roamerat në TM4 të vitit 2023 kap shifren prej 1,039,986.

Kurse në tabelën e mëposhtme janë paraqitur vetëm numrat aktiv të Vala:

	Në databazën e konsumatorëve (SDM), janë konfiguruar		prepaid dhe postpaid aktiv	
	2022	2023	2022	2023
2G			377,463	218,167
3G	885,224	897,448	230,457	143,622
4G	518,112	697,650	216,435	481,503

Tabela 2. Numrat aktiv të Vala

Trendet e lëvizjes së numrit total të konsumatorëve aktiv në tri vitet e fundit nuk tregojnë për ndonjë lëvizje të theksuar, me përashtim të periudhave kohore rreth festave kur reflekton prezencia e shtuar e bashkatdhetarëve. Nga shifrat e cekura më lart vërehet rritje më tepër se dyfish e konsumatorëve aktiv 4G, dhe zvogëlim i konsiderueshëm i konsumatorëve 2G dhe 3G.

Ky ndryshim e ka shpjegimin e vet logjik në faktin se me implementimin e projektit "Migrimi në kodin telefonik të RKS dhe Modernizimi i rrjetit mobil", teknologjia 4G/4G+ ka marrë rolin dominant në teknologjinë mobile të Telekomit të Kosovës.

Diagramet që paraqesin volumin kumulativ favor të trafikut mobil Voice dhe Data mund t'i gjeni në shtojcën d. vi.

Interkoneksion - Zëri mobil

Të hyrat nga trafiku ndërkombëtar në ardhje në 2023, krahasuar me 2022, kanë pasur nivel përafërsisht të njëjtë: €3.19M nga €3.17M. Në këto të hyra pjesa kryesore vjen nga telefonia mobile.

Shpenzimet për trafikun ndërkombëtar në shkuarje në 2023, krahasuar me 2022, janë rritur për 4%, €2.21M nga €2.12M. Ndonëse është regjistruar rënje në volumet e trafikut për 3%, tarifa e terminimit rezulton e ngritur për 7% në periudhën raportuese.

Roaming

- Zgjerimi i mbulueshmërisë me shërbimet e munguara roaming, si LTE e CAMEL - janë lansuar një dyzinë relacionesh të reja (marrëveshje të reja ose zgjerim shërbimesh).
- Performanca komerciale e roamingut në vitin 2023, në mënyrë të pritshme, nuk ka vazhduar trendin e përmirësimit pas vitit të pandemisë 2020. Ka ulje në të hyrat Inbound, kryesisht për shkak të uljes së vazhdueshme të tarifave ndërmjet operatorëve dhe efektit të rritur të ndarjes së tregut me konkurrencën.
 - Të hyrat neto inbound janë ulur për 9%, €1.6M nga €1.77M.
 - Shpenzimet neto outbound janë rritur vetëm 10%, €634k nga €578k.
 - Si rezultat, neto pozicioni ose marginja e përgjithshme është ulur për 18%, €970k nga €1.19M.

ii. Shërbimet fiksë

Sa i përket infrastrukturës së Telekomit të Kosovës për shërbimet fiksë, shërbimet e konsumatorëve ofrohen nëpërmjet rrjetit qendoror dhe të qasjes në gjatësi mbi 1000 km me optikë (kapacitete transportuese, rrjeta FTTH dhe FTTN), 150 pika të prezencës fiksë me 350 nyje të qasjes, 416 WiFi pika të qasjes dhe 2 sisteme komutuese EWSD PSTN me 30 pika të qasjes RDLU.

Platformat teknologjike janë të bazuara në NGN, EWSD PSTN, IPTV dhe WiFi. Numri i konsumatorëve fiks me faturë jozero, në fund të vitit 2023 është: 26.294. Këta konsumatorë kanë një ose më shumë shërbime prej listës së shërbimeve që ofrohen - Zë, Internet, IPTV, VPN, ISDN, Centrex.

Strategjia e Marketingut e TK-së për vitin 2023, konsiston në ofrimin dhe promovimin e atyre shërbimeve që TK-në e pozicionojnë si Brend të orientuar ndaj vlerave të familjeve që në përvojën e përgjithshme të konsumatorëve përfaqëson kualitetin, sigurinë dhe inovacionin, në të gjitha pikat e kontaktit.

Në aspekt të aktiviteteve të lansimit të produkteve, promocioneve dhe aktiviteteve tjera në kuadër të marketingut, TK ka qenë aktiv duke ofruar produkte atraktive për konsumatorë.

Vlen të përmenden plotësimet e vazhdueshme të pakove të kombinuara të Zërit, Data dhe TV, me qëllim të rritjes së atraktivitetit të shërbimeve. Indikatorët e performancës për vitin 2023, janë paraqitur në tabelat e shtojcës d. vi.

d. Pasqyra e performancës financiare dhe rezultatet 2023

Përkundër vështirësive dhe gjendjes jo të mirë të trashëguar viteve të fundit, si rezultat i marrjes së një varg masash për rritjen e të hyrave, investimet në teknologji, modifikimi dhe krijimi i pakove atraktive dhe reduktimi i të gjitha kategorive të shpenzimeve, në vitin 2023 është krijuar një stabilitet finansiar i kompanisë.

Veçanërisht, reduktimi i shpenzimeve të stafit por edhe i shpenzimeve të tjera operative kanë mundësuar që mjetet e kursyera të përdoren për pagesën e detyrimeve tatimore dhe detyrimeve të tjera të akumuluara nga vitet e tjera.

Si rezultat, është arritur qe të reduktohen obligimet ndaj kreditorëve dhe aktualisht të gjitha obligimet që krijohen paguhen brenda afatit. Po ashtu obligimet tatimore të krijuara gjatë viteve të mëhershme janë paguar tërësisht.

Po ashtu gjatë vitit 2023 kompania ka arritur të paguajë me burimet e brendshme të gjitha faturat për tarifat e ARKEP që i takojnë vitit 2023 në vlerë mbi 2.5 mil. euro, duke shmangur kamatat që aplikohen për vonesa në pagesë.

Kjo ka ndikuar që të shmangen shpenzimet e gjobave dhe kamatave, të cilat viteve të fundit kanë ngarkuar pasqyrën e të ardhurave.


Po ashtu gjatë vitit 2023 obligimet ndaj kreditorëve tjerë janë zvogëluar në minimum dhe aktualisht kemi vetëm obligimet e rregullta/rrjedhëse që paguhen brenda afatit të pagesave sipas kontratave pothuaj për të gjithë kreditorët.

Edhe kjo ka ndikuar që shpenzimet për kamata dhe shpenzimet përmbarimore të zvogëlohen në minimum.

Ndonëse në vitin 2023 kompania ka operuar me fitim neto në vlerë rreth 8 mil. euro dhe ka përmirësim të dukshëm të gjendjes financiare, mbeten tepër sfiduese obligimet nga kontestet gjyqësore.


Projektet investive të realizuara gjatë vitit 2023 pjesërisht janë paguar nga burimet vetanake dhe pjesërisht nga burimet e huasë që kemi pranuar nga aksionari.

Në vijim është paraqitur përbledhja e të hyrave, ku përfshihen kontributet në të hyra nga shërbimet mobile & fikse.



Në grafikun e paraqitur më lart, figurat e vitit 2023 janë rezultate nga Pasqyrat Financiare ende të paauditara, duke përfshirë këtu edhe të hyrat nga donacionet qeveritare si dhe të hyrat e bazuara në vendimet gjyqësore dhe rimbursimi në emër të TVSh-së paguar nga ana e ATK-së.

Në aspekt të performancës, trendi në rënje gjatë viteve paraprake, nga viti 2021 - 2023 tregon kthim përkatesisht trend rritës të të hyrave. Në krahasim me vitin 2022, të hyrat e TK-së në vitin 2023 paraqiten më të larta për 8.51%.




Kontributi i të ardhurave në vitin 2023, në mes të shërbimeve mobile dhe shërbimeve fikse, është në proporcionin 89% me 11% në të mirë të shërbimeve mobile.

Struktura e këtyre shërbimeve në vitin 2023 krahasuar me vitin 2022 ka një ndryshim për 1%, e cila në vitin paraprak paraqitej në proporcionin 88% me 12% në të mirë të shërbimeve mobile.

Në grafikonin në vijim janë prezantuar rezultatet e performancës duke përfshirë EBITDA dhe fitimin /humbjen për vitet 2016, 2017, 2018, 2019, 2020, 2021, 2022 dhe 2023.

Në aspektin e performancës në vitin 2023, TK ka realizuar EBITDA pozitive në vlerë prej 17,5 mil. euro. Nëse krahasohet me vitin 2022, EBITDA 2023 është më e favorshme për 7,5 mil. euro në periudhën raportuese, nga 10.0 mil. euro, sa ishte realizuar në 2022. Krahasuar me buxhetin 2023, EBITDA aktuale është më e favorshme për 11,3 mil. euro nga 6,2mil. euro sa ishte planifikuar për 2023.




Fitimi para tatimit për TK-në, në vitin 2023 paraqitet në vlerë prej 7.9 mil. euro, që kahasuar me vitin 2022 është më i favorshëm për 11,6 mil. euro, nga -3,7 mil. euro sa ishte humbja në 2022, kurse në kahasim me buxhetin, fitimi aktual është më i favorshëm për 8,6 mil. euro, nga -0.7mil. euro, sa ishte humbja e planifikuar'22.

e. Progresi me Planin e Biznesit

Kahasuar me buxhetin e vitit 2023, kompania ka arritur që të jetë përafërsisht brenda parametrave sa i përket të hyrave, duke realizuar 101.84% të të hyrave të planifikuara, përkatësisht janë realizuar 57.4 mil.euro nga 56.4 mil.euro sa ishin planifikuar. Ndërsa kahasuar me vitin e kaluar, të hyrat aktuale 2023 janë realizuar në masën 108.61% nga 52.9 mil. euro sa ishin realizuar në vitin 2022.

Për sa u përket shpenzimeve në përgjithësi, janë më të ulëta se shpenzimet e planifikuara '23, për 13.18% ose për 7,516k euro më pak, ndërsa kahasuar me vitin 2022, shpenzimet e përgjithshme janë për 12.40% më të ulëta ose për 7,006k euro.

Sipas Planit të Biznesit 2023, ishte parashikuar që kompania të operojë me humbje në vlerë prej -0.7 mil. euro, por për shkak të uljes së shpenzimeve dhe performancës pozitive, kompania në fund të vitit 2023, ka rezultuar të operojë me fitim në vlerë prej 7.9 mil. euro.



Në grafik është bërë krahasimi me vitet 2016, 2017, 2018, 2019, 2020, 2021, 2022 dhe rezultati i vitit 2023 (A- arritur) si dhe buxheti për vitin 2023 (B-buxhet i planifikuar).

Të hyrat totale të realizuara në vitin 2023 janë në vlerë prej 57.4 mil.euro e që janë për 8.61% më të larta se vitin e kaluar ndërsa krahasuar me planin janë për 1.84% më të larta.

EBITDA e realizuar në vitin 2023 është në vlerë pozitive prej 17.5 milionë euro dhe paraqet rezultat më të favorshëm për 7.5 milionë euro sesa EBITDA e realizuar në 2022 prej 10 milionë euro, kurse krahasuar me planin, EBITDA aktuale 2023 është më e favorshme për 11.3 milionë euro nga ajo e planifikuar prej 6.2 milionë euro.

Fitimi para tatimit i realizuar në vitin 2023 paraqitet në vlerë prej 7.9 mil. euro, që paraqet rezultat më të favorshëm për 11.6 milionë euro nga -3.7 milionë euro sa ishte humbja në 2022, kurse krahasuar me planin, fitimi për vitin 2023 është më i favorshëm për 8.6 milionë euro nga -0.7 milionë euro sa ishte humbja e planifikuar për 2023.

f. Shpenzimet kapitale dhe projektet

1. Gjatë vitit 2023, dinamika e implementimit të projekteve kapitale, ka qenë në një nivel shumë të kënaqshëm. Telekomi i Kosovës ka vazhduar orientimin në realizimin e projekteve kapitale për zhvillimin dhe zgjerimin e infrastrukturës në drejtim të një rrjete të integruar telekomunikuese. Kjo infrastrukturë telekomunikuese ofron mundësitë për shërbime konvergjente si dhe zgjeron mundësitë teknike për një portfolio të shërbimeve që plotëson nevojet aktuale të konsumatorëve. Nder projektet kryesore investive ne implementim janë: "Migrimi në kodin telefonik të RKS dhe Modernizimi i rrjetit mobil", platforma OTT, projekti i Sigurise Kibernetike, Instalimi i Pajisjeve Aktive XGS-PON, projekti KODE i lidhjes së SB-ve me rrjetin optik, etj.

2. Migrimi në kodin telefonik të RKS dhe Modernizimi i rrjetit mobil

Në bazë të kontratave me Ericsson për lotet 1 e 2 dhe kontratës me Intracom për lotin 3, ka filluar implementimi i projektit, me të cilin do të përmirësohet dukshëm kualiteti i shërbimeve telekomunikuese në rrjetin mobil.

Lot 2, me 120 sajte në rrethin Ferizaj dhe Gjilan, për 2G dhe 4G+ do të përfundohet në fillim të vitit 2024. SB-të e vjetra ALU janë zhvendosur dhe ri-integruar në pjesë tjera të rrjetit, duke shtuar në këtë mënyrë kapacitetet dhe duke përmirësuar kualitetin në ato zona.

10 sajte të kontraktuara për 5G do të implementohen në 2024 pas migrimit në Core të Ericsson, pjesë e kontratës Loti 1. Në përgjithësi, pas përbylljes të Loteve 1 e 2, rrjeti mobil do të jetë i gatshëm për avancim në 5G.

Kontrata me Ericsson për Lot 1, me të cilën do të modernizohet rrjeti qendror mobil, përfshirë ndërrimet e nevojshme për kodin e Kosovës, është duke u zbatuar. Pajisjet dhe sistemet janë instaluar në Data Center dhe janë integruar me pjesët tjera të rrjetit. Testimet e fundit janë duke u kryer para se të kalojmë në fazën e migrimit të plotë në 2024.

Kontrata me Intracom për Lot 3, me të cilën do të modernizohet sistemi i faturimit, është duke u zbatuar, po ashtu. Pajisjet dhe sistemet janë instaluar në Data Center dhe janë integruar me pjesët tjera të rrjetit. Testimet e fundit janë duke u kryer para se të kalojmë në fazën e migrimit të plotë në 2024.

Për më tepër, është nënshkruar kontrata me dt.24.10.2023 për furnizimin me 30 SB dhe ka filluar implementimi i saj, duke përfshirë edhe vizitat në terren. Afati i liferimit dhe instalimit është 26 javë.

3. Platforma OTT

- Pas negociatave, është shpallur fitues Konsorciumi: UniqCast Croatia & Cactus Sh.a. Kosova
- Kontrata është nënshkruar (protokolluar nga Arkivi i TK): 28.04.2023 me nr.01-1568/23
- Pranimi teknik është realizuar më 29.09.2023, me nr.03-3829/23
- Përdoruesit e parë kane filluar të aktivizohen më 02.10.2023.

4. Projekti i Ekonomisë Digitale për Kosovën (KODE)

- Duke ju referuar Marrëveshjeve për Grante të nënshkruara në shtator 2022 me Ministrinë e Ekonomisë, në kuadër të "Projektit të Ekonomisë Dixhitale për Kosovën (KODE) M01/22", kemi realizuar shtrirjen dhe kalimin në optikë të 11 SB-ve, prej tyre në 6 lokacione (të cilat janë në Reģionin e Ferizajit dhe Gjilanit) edhe pajisjet aktive, ndërsa në 5 lokacione vetëm shtrirjen e rrjetit optik.
- Në fund të muajit shkurt 2023, Ministria e Ekonomisë në kuadër të Projektit të Ekonomisë Digitale për Kosovën (KODE) ka publikuar thirrjen për aplikim M01/23 sipas skemës së Granteve. 80% e vlerës totale të projekteve pa TVSH financohet nga Ministria e Ekonomisë ndërsa 20% e vlerës totale të projekteve pa TVSH financohet nga Telekomi i Kosovës. Telekomi i Kosovës ka përfituar 7 Lote për lidhjen e SB-ve me optikë dhe ka nënshkruar Marrëveshjet e Granteve me Ministrinë e Ekonomisë. Prej tyre, në 5 lokacione ka përfunduar shtrirja e rrjetit optik dhe kalimi në mediumin optik, ndërsa në 2 lokacione punimet janë në fazën përfundimtare të realizimit. Këto projekte kompletohen kur të liferohen dhe instalohen pajisjet aktive të cilat janë të kontraktuara.


- Po ashtu, duke ju referuar Marrëveshjeve të Granteve dhe obligimeve kontraktuale të ndërsjella ku përfitues është IPKO, kemi lidhur me optikë edhe 4 SB.
- Përveç investimeve të cekura më lart, TK është duke vazhduar edhe me investime të limituara në rrjetat e qasjes optike në territorin e Republikës se Kosovës, në mënyre që mediumi qasës mobil/fiks i konsumatorit (ndërlidhja e SB-ve nëpërmjet infrastrukturës optike si dhe zgjerimi i FTTH GPON), të funksionalizojnë mundësitetë performuese të platformës telekomunikuese. Në rastet e rrjetit të qasjes me çiftore bakri, po punohet në segmentimin e tyre.
- Investimet tjera të projekteve kapitale përfshijnë avancime të platformave ekzistuese të TK-së, ku me theks të veçantë është integrimi i platformave të cilat mbështesin proceset kyçe të biznesit në TK dhe të platformave të faturimit. Ky integrim, mundëson automatizimin e proceseve të punës dhe konvergjencën e shërbimeve mobile dhe fikse.

Furnizimi me SAN (Storage Area Networks) dhe Serverë

- Objektivi kryesor i këtij projekti ishte rritja e performancës së SAN-it ekzistues., Me këtë projekt do të ofrojë zgjidhjen më të mirë për platformat CRM dhe Serverëve të Faturimit.
- Me këtë projekt, hardueri CRM do të zëvendësohet nga pajisjet e vjetra në pajisje më të reja dhe me performancë shumë më të mirë, kjo vlen edhe për Serverin e Faturimit.
- Aktualisht jemi në fazën e fillimit për migrimin e të gjithë platformës ku do të paguhen shërbimet profesionale dhe licencat e nevojshme.

Është investuar edhe në platformën për siguri kibernetike. Me planifikimin e buxhetit 2023, janë miratuar investime kapitale në vlerë të përgjithshme prej 23,169k euro. Prej tyre, për infrastrukturën mobile janë aprovuar 14,622k euro, për atë fikse 8,427k euro dhe për shërbimet mbështetëse 120k euro.

Planifikimi dhe realizimi i investimeve kapitale për vitin 2023, me sa vijon:



Investimet Kapitale (Capex) – gjatë vitit 2023, janë realizuar pagesa në vlerë prej 7,375k euro, prej tyre 4,895k euro në emër të shërbimeve mobile, 2,474k euro në emër të shërbimeve fikse dhe 6k euro në emër të njësive tjera.

Gjatë kësaj periudhe janë iniciuar kërkesa në vlerë prej 7,866k euro, në përputhje me Planin e Biznesit të aprovuar për vitin 2023. Kërkesat janë iniciuar në emër të shërbimeve të rrjetit fiks 3,728k euro, kërkesa për shërbimet mobile 4,104k euro dhe kërkesa për NJM Logistikë 44k euro.

g. Perspektiva për të ardhmen

Të gjithë indikatorët dhe projekzionet tregojnë që përmirësimi i gjendjes financiare do të vazhdojë edhe në vitin 2024.

Kjo bazohet në trendin e rritjes së të hyrave, implementimin e projekteve dhe investimeve në përmirësimin e shërbimeve në mesin e vitit 2024, reduktimin e vazhdueshëm të shpenzimeve etj.

Sigurimi i financimit të projekteve apo investimeve përmes kredive afatgjata do t'i mundësojë kompanisë që të mos ketë presion nga rreziku i likuiditetit.

Vazhdimësia e përkrahjes financiare mundëson zhvillimin e projekteve dhe realizimin e objektivave strategjike të parapara për periudhën 2024-2026. Shërbimet telekomunikuese të cilat i takojnë gjeneratës se re teknologjike mbeten në planin e zhvillimit dhe orientimit tonë strategjik.

Finalizimi i ristrukturimit do të ndikojë në funksionalizimin dhe koordinimin më të mirë të të gjitha departamenteve.

Konsolidimi i numrit të konsumatorëve, i shoqëruar me përmirësimin e brendit përmes rritjes së kualitetit të produkteve dhe formave të ofrimit të shërbimeve (shitjeve), përmirësimit të komunikimit me konsumatorë, duke ngritur kështu përvojën e përgjithshme të tyre, pritet të reflektojë në rritjen e ARPU-së dhe rrjedhimisht në rritjen e të hyrave.

Gjithashtu, implementimi i projektit për modernizim dhe zgjerim të rrjetit telekomunikues primar dhe sekondar përmes mediumit optik. Implementimi i këtij projekti do të ndikojë në rritjen e numrit të konsumatorëve fiks, po ashtu do të shërbejë "fronthaul" për shërbimet e avancuara mobile – 5G.

Për më tepër, vazhdon implementimi i projektit të modernizimit të rrjetit mobil në tërë Kosovën.

Duke cekur pikat e lartpërmendura, Telekomi synon t'i arrijë këto objektiva:

- Rritjen e ARPU-së, e cila synohet të arrihet përmes shtimit kuantitativ dhe kualitativ të shërbimeve dhe rritjes së analizuar të çmimeve, duke përmirësuar shërbimet ekzistuese me kombinime të reja.
- Rritja e bazës së konsumatorëve do të bëhet përmes: shtimit kuantitativ dhe kualitativ të shërbimeve, dhe përmes pakove adekuate PrePaid dhe PostPaid.
- Përmirësimi i imazhit të brendit (Brand Awareness) do të bëhet përmes: kampanjave promovuese, që përveç rritjes së objektivave të caktuara, e ngritin edhe imazhin e brendit të kompanisë; përmirësimit të shërbimit të konsumatorëve (Total Customer Experience).

Arritura e këtyre objektivave ndërlidhet ngushtë me investimet e nevojshme në platforma teknologjike dhe rrjeta telekomunikuese, që rezultojnë në ngritjen e nivelit të shërbimeve, e rrjedhimisht me kënaqshmërinë e konsumatorëve me shërbimet tona.

h. Rreziqet e të ardhmes së Korporatës

Menaxhimi i rrezikut paraqet njërin ndër faktorët kryesor që do të sigurojë se Telekomi i Kosovës është duke u kujdesur në sigurimin e performancës pozitive e cila garanton se është në linjë të zhvillimit në interes të vetë punonjësve, konsumatorëve, aksionarit dhe shoqërisë në përgjithësi.

Realizimi i investimeve strategjike në teknologji është rrezik permanent, si: sendërtimet dhe integrimet e sistemeve, dështimet teknike, tejkalimet e kostos etj.

Përkundër përmirësimeve të dukshme të paraqitura më lart, kompania ende përballet me rreziqe financiare dhe pasiguri të cilat kryesisht kanë të bëjnë me kontestet gjyqësore që lidhen me dy vendime të arbitrazhit me rastin Dardafon.

Aktualisht, obligimet kontestuese që lidhen me këto dy vendime sipas pretendimeve të Dardafon sillen rreth 21 milion €.

Për vendimin e parë të arbitrazhit, pretendimi i Dardafon është borxhi i mbetur rreth 5.7 milion €, ndërsa sipas Telekomit, obligimet lidhur me vendimin e parë të arbitrazhit jo vetëm që janë paguar tërësisht por edhe janë tejkular për rreth 14 milion €.

Ndërsa, lidhur me vendimin e arbitrazhit të dytë, pretendimi i Dardafon është rreth 15 milion € përfshirë edhe kamatat deri më 31/12/2023.

Të dy rastet aktualisht janë në procese gjyqësore. Për arbitrazhin e parë gjasat janë që epilogu gjyqësor të merret gjatë vitit 2024.

Për momentin, përvèç rasteve të përmendura, ekziston rreziku i inicimit të disa proceseve të reja në arbitrazhin vendor ose ndërkombëtar, sikurse janë rastet e disa kontraktorëve me të cilët ka mospajtime lidhur me zgjidhjen e disa mosmarrëveshjeve në implementimin e kontratave komerciale, dhe atë:

Kontestet gjyqësore, arbitrazhet, bllokimi i llogarive bankare të Telekomit të Kosovës për shkak të inicimit të procedurave përmbarimore nga ana e operatorëve ekonomik dhe institucioneve tjera; numri tejet i madh i rasteve të padive të punonjësve të Telekomit të Kosovës, me rastin e vendimeve të mëhershme mbi riorganizimet e vendeve të punës dhe ndryshimit të gradave, raste/padi të cilat përbajnë vlera të larta monetare në dëm të Telekomit të Kosovës.

Bazuar në evidencën e lëndëve, kundër korporatës aktualisht janë duke u zhvilluar disa procese legale që kanë rëndësi të madhe. Për më shumë shiko shtojcën iii.

Rezije të rëndësishme për Telekomin e Kosovës gjatë vitit 2024, mbesin çështjet si:

- Mosinkasimi i llogarive të arkëtueshme, të rasteve të iniciuara në gjykata për propozim përmbarim dhe depozitës financiare të mbetur në Bankën Kreditore të Prishtinës me rastin e falimentimit të kësaj banke.
- Reziku i humbjes së pasurisë intelektuale të korporatës, mosha e shtyrë e stafit (rreth 50 vjeç) Konkurrenca ilegale (IPTV dhe Internet).
- Mungesa e infrastrukturës se nevojshme telekomunikuese në lokacionet ku kërkohet ofrimi i shërbimeve të reja, duke përfshirë edhe pajisjet e nevojshme, e cila pastaj shkakton vonesa në përbushjen e kërkeseve të rritje të konsumatorëve.
- Dëmtimi i infrastrukturës nga OE (punëkryesit e ndryshëm të angazhuar) në trasetë e rrugëve magjistrale ku është e shtrirë infrastruktura telekomunikuese.
- Institucionet e Republikës së Kosovës (IRK), si Autoritete Kontraktuese (Autoritete Publike), vazhdojnë në disa raste të marrin shërbime telekomunikuese të konkurrencës në kundërshtim me interpretimin

ligjor të Paragrafit 4 të Nenit 9 të Ligjit të Prokurimit Publik (LPP) të bërë nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRPP).

- Vjetërsia e objekteve, rrjetit energetik, nyjeve sanitare, infrastrukturës së jashtme (dritaret) si dhe automjeteve.

i. Kalendari finançiar

Auditimi i Pasqyrave Financiare për vitin
2023 nga Auditorët e Jashtëm duhet të
prezantohet deri më datë: **30.06. 2024**

Figurat e pasqyruara në këtë raport për vitin
2023 paraqesin rezultatet preliminare të
paaudituara.

Bazuar në kalendarin e pasqyruar më lart, raporti i Auditorit të Jashtëm dhe Pasqyrat Financiare të Audituara pritet të publikohen deri më **30.06 2024**. Telekomi i Kosovës është në proces të auditimit të Pasqyrave Financiare nga ana e Zyrës Kombëtare të Auditimit për periudhën Janar-Dhjetor 2023, dhe pritet që brenda afatit ligjor të finalizohen Pasqyrat Financiare dhe Raporti i Auditorit.

VI. Shtojca

a. Statuti i TK-së

(bashkangjitur si pdf)

b. Pasqyrat financiare preliminare për vitin 2023

(bashkangjitur si pdf)

c. Sponsorizimet dhe donacionet

(Për shkak të gjendjes jo të mirë financiare, Korporata nuk ka mbështetur kërkuesat për sponsorizime dhe donacione)

d. Raportimet sipas ligjit mbi ndërmarrjet publike

- i. Pasqyra e strukturës organizative
- ii. Shqyrtim i performancës afariste dhe financiare gjatë viti përkatës (kjo pjesë është e plotësuar në kuadër të raportit)
- iii. Përbledhje e të gjitha procedurave gjyqësore ose të arbitrazhit, të pambaruara ose të kërcënura, ose dhe rreziqet që mund të përfshijnë korporatën
- iv. Transaksionet e konsiderueshme që përfshijnë NP ose njësitë e saj ndihmëse
- v. Sugjerime dhe propozime për ndryshime të cilat me arsyе pritet që ta rrisin performancën e NP-së (kjo pjesë është e plotësuar në kuadër të raportit)
- vi. Performanca e sistemeve telekomunikuese

d. Raportimet sipas ligjit mbi ndërmarrjet publike

Në kuadër të përmbushjes së kësaj dispozite parashihet plotësimi i të dhënave si në vijim:

i. Pasqyrat e strukturës organizative

Pasqyrat e strukturës organizative duke përfshirë të gjitha ndryshimet e konsiderueshme që janë bërë gjatë viti përkatës
Struktura organizative e Telekomit të Kosovës Sh.A




Figura 1: Struktura e vjetër organizonte




Figura 2: Struktura e re organizative

PAQYRA E NDRYSHIMEVE: Janar - Dhjetor 2023

Gjatë vitit 2023 ka filluar implementimi i procesit të ristrukturimit, përkatesisht kalimi nga struktura si në Figura 1: Struktura e vjetër organzative në Figura 2: Struktura e re organizative. Gjatë periudhës rapportuese të viti 2023 janë shpallur gjithsej 100 konkurse prej të cilave: 94 konkurse të brendshme dhe 6 konkurse të jashtme. Prej 100 konkurseve gjatë viti 2023, 78 kanë përfunduar me nënshkrim të kontratës dhe 4 konkurse kanë mbetur në proces (deri në përpilimin e këtyj raporti 4 konkurstet në proces kanë përfunduar me nënshkrim të kontratës). Gjatë periudhës rapportuese janë identifikuar, ricaktuar dhe nënshkruar edhe 342 kontrata me të cilëve janë ekivalente me strukturën e re organzative.

PAQYRA E NDRYSHIMEVE: Janar - Dhjetor 2023

Gjatë periudhës reportuese rezultojnë gjithsej **65** punëtorë pasiv të kategorizuar si më poshtë:

- ndërprerje e marredhënies së punës me vjetëdeshirë 2 punëtorë dhe ndërprerje e marredhënies së punës nga punëdhënësi 9 punëtorë, që në total janë gjithsej **11** punëtorë;
- të pensionuar - **51** punëtorë;
- kanë ndërruar jetë - **3** punëtorë.

PAQYRA E NDRYSHIMEVE:

Departamenti	Numri i punëtorëve në TK Sh.A gjatë vitit 2023											
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
Zyra e Drejtitorit Menaxhues	23	23	23	23	23	23	23	23	22	22	22	22
Departamenti i Marketingut	54	54	54	54	54	53	53	54	54	54	54	57
Departamenti për Strat. dhe Zhvillim të Biznesit	4	4	4	4	4	4	4	4	4	4	4	4
Departamenti për Hetime kundërmashtrimeve	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2
Departamenti për BNJ & Administratë	19	19	19	19	19	19	19	19	20	21	20	20
Zyra e Sekretariatit / Bordit	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Departamenti i Prokurimit	16	16	16	16	16	16	16	16	16	16	16	16
Departamenti për Relacion me Publikun	13	13	13	13	13	13	13	13	13	13	13	12
Departamenti për Logistikë	284	284	282	277	276	276	275	274	273	273	273	273
Departamenti i Shëties	547	545	544	543	543	542	540	539	538	537	533	529
Departamenti për Punë të Korporatës	36	35	35	35	35	35	34	34	34	35	35	34
Departamenti për Trajnim dhe Zhvillim	9	9	9	9	9	9	9	9	9	9	9	9
Departamenti i Auditimit	3	3	3	3	3	3	3	4	3	3	3	3
Departamenti i Financave	140	141	140	140	140	139	139	139	141	139	139	138
Departamenti Teknik	648	646	645	646	643	641	641	638	635	633	633	631
Total të punësuar me kontratë të rregullt:	1798	1794	1789	1784	1780	1775	1771	1768	1765	1760	1756	1750
Të punësuar me kontratë mbi vepër:	4	7	9	9	9	8	8	7	7	6	6	6
Total të punësuar:	1802	1801	1798	1793	1789	1784	1779	1776	1772	1767	1762	1756

Tabela 4. Të punësuarit e njërrë nga sistemi në fund të çdo muajit

Sic mund të vërehet nga paraqita tabelore e lëvizjes së stafit nëpër departamente, numri i të punësuarve është në rënje e sipër.

NDRYSHIMET E POZITAVE TË NIWELIT DREJTUES, PASQYROHEN SI MË POSHTË:

KOMISIONI PËRGJEDHËS, ME DATË 10.02.2023 PËR POZITËN ZYRTAR KRYESOR I FINANCAVE DHE THESARIT, PËRGJODHI FEIM KELMENDI
KOMISIONI PËRGJEDHËS, ME DATË 02.05.2023 PËR POZITËN DREJTOR - DREJTORIA TEKNIKE DHE IT, PËRGJODHI HALL KRASNIQI
KOMISIONI PËRGJEDHËS, ME DATË 02.05.2023 PËR POZITËN DREJTOR - DREJTORIA E KORPORATËS, PËRGJODHI LEONORA SYLAJ
KOMISIONI PËRGJEDHËS, ME DATË 15.05.2023 PËR POZITËN DREJTOR - DREJTORIA SHITJA, MARKETINGU DHE KUIDESI PER KONSUMATORË PËRGJODHI AVNI
TAFILAJ

KOMISIONI PËRGJEDHËS, ME DATË 24.07.2023 PËR POZITËN ZYRTAR I AUDITIMIT TË BRENDSHËM, PËRGJODHI KUJTIM SARAÇI

RREGULLORET DHE DRAFT RREGULLORET

- ME DATË 13.01.2023 ËSHTË MIRATUAR RREGULLORE PËR MENAXHMIN, ADMINISTRIMIN DHE PËRMBAJTJEN E DOSJËS PERSONALE TË TË PUNËSUARVE NË TELEKOMIN E KOSOVËS SH.A. NR.01-5286/22
- ME DATË 28.03.2023 ËSHTË MIRATUAR RREGULLORE PËR NDRYSHMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES PËR MARRËDHËNIE PUNE, NR.01-2978/22 E DATËS 27.06.2022
- VENDIM I BID 01-2978/22 DATË 07.07.2023 PLOTËSIM/NDRYSHIM I NENIT 13 PIKA 4 DHE NENI 25 PIKA 1 I RREGULLORES PËR MARRËDHËNIE PUNE NR.01-2978/22 E DATËS 27.06.2022 E PLOTËSUAR DHE NDRYSHUAR ME RREGULLOREN NR.01-2978/22 E DATËS 28.03.2023
- VENDIM I BID 01-2710/23 DATË 07.07.2023 MODIFIKIMI I KRITERIT TË PARË NË KONKURSET E BRENDSHME

ËSHTË PUNUAR

- DRAFTI I KODIT TË MIRËSJELLJES SË PUNONJËSVE DHE PROCEDURAT DISPLINORE
- DRAFTI I PROCEDURAVE STANDARDE TË OPERIMIT

ii. Shqyrtimi i performancës afariste dhe financiare gjatë vittit 2023

(Kjo pjesë është plotësuar në kuadër të këtij raporti)

iii. Përbledhje e të gjitha procedurave gjyqësore ose të arbitrazhit, të pambaruara ose të kërcënua, ose që mund të përfshijnë korporatën

Menaxhimi i rezikut paraqet njërin ndër faktorët kryesor që do të sigurojë se Telekomi i Kosovës është duke u kujdesur në sigurimin e performancës pozitive e cila garanton se është në linjë të zhvillimit në interes të vetë punonjësve, konsumatorëve, aksionarit dhe shoqërisë në përgjithësi. Telekomi i Kosovës aktualisht ballafaqohet e një numër të rreziqeve, të cilat kualifikohen e listohen si: financiare, teknike, ligjore, operacionale, strategjike e të jashtme.

Pamundësia e realizimit të investimeve strategjike në teknologji, do të paraqiste rezik permanent, duke pasur parasysh se rrjeti i TK-së momentalisht përballet me shumë pengesa. Gjendja e platformave dhe sistemeve telekomunikuese vazhdon të jetë e rëndë, që rrjedhë nga mungesa e investimeve dhe mirëmbajtjes së platformave, përkatësisht, të arritjes së kontratës aktive për mirëmbajtjen dhe përkrahjen teknike të platformave të sistemeve telekomunikuese.

Përkundër përmirësimeve të dukshme të paraqitura më lartë, kompania ende përballet me rreziqe financiare dhe pasiguri të cilat kryesisht kanë të bëjnë me kontestet gjyqësor, dhe rastet e arbitrazhit e posaçërisht që lidhen me dy vendime të rastit Dardafon.Net L.L.C.

Për vendimin e parë të arbitrazhit, pretendimi i Dardafon.Net L.L.C. është borxhi i mbetur rrëth 5.7 Milionë €, ndërsa sipas Telekomit, obligimet lidhur me vendimin e parë të arbitrazhit jo vetëm që janë paguar tërësisht por edhe janë tejkaluar, pretendime këto të cilat janë duke u përdorur në procedurë nga Telekomi.

Ndërsa, lidhur me vendimin e arbitrazhit të dytë, pretendimi i Dardafon.Net L.L.C është rrëth 15.5 Milionë Euro përfshirë edhe kamatat deri më 31/12/2023.

Të dy rastet aktualisht janë në procese gjyqësore.

Në rast se kemi epilog negativ për Telekomin e Kosovës karshi pretendimeve të lidhur me këto dy procese gjyqësore, e vetmja mundësi për kryerjen e këtyre obligimeve është futja në marrëveshje për pagesë me këste dhe apo gjetja e zgjidhjeve alternative.

Kjo përveç se mund të ketë kosto shtesë për Telekomin, do të ishte barrë tepër e rëndë për kompaninë dhe do të vështirësonte operimin për vitet sa do të zgjasë pagesa eventuale e kësteve.

Telekomi do të shfrytëzojë çdo mjet ligjor në dispozicion për të fituar këto dy beteja ligjore pasi që këto raste gjyqësorë paraqesin rastet me të ndjeshme për të ardhmen e kësaj ndërmarrje publike.

Për momentin, përveç rasteve të përmendura gjyqësor me lartë dhe atyre të arbitrazhit, ekziston reziku i inicimit të disa proceseve të reja në arbitrazhin vendor, sikurse janë rastet e disa kontraktorëve me të cilët ka mospajtime lidhur me zgjidhjen e disa mosmarrëveshjeve në implementimin e kontratave komerciale, dhe atë:

- Kontestet gjyqësore, arbitrazhet, bllokimi i llogarive bankare të Telekomit të Kosovës për shkak të iniciimit të procedurave përmbarimore nga ana e operatorëve ekonomik dhe institucioneve tjera;
- numri tejet i madh i rasteve të padive të punonjësve të Telekomit të Kosovës, me rastin e vendimeve të mëhershme mbi riorganizimet e vendeve të punës dhe ndryshimit të gradave, raste/padi të cilat përbajnë vlera të larta monetare në dëm të Telekomit të Kosovës.

Bazuar në evidencën e lëndëve, kundër korporatës aktualisht janë duke u zhvilluar disa procese legale që kanë rëndësi të madhe, dhe një dozë të rrezikut me kosto rrëth tre (3) milion euro.

Rezije që tjetra për Telekomin e Kosovës gjatë vitit 2023, mbesin çështjet si:

Mos inkasimi i llogarive të arkëtueshme, të rasteve të iniciuara në gjykata për propozim përmbarim dhe depozitës financiare të mabetur në Bankën Kreditore të Prishtinës me rastin e falimentimit të kësaj banke;

Rreziku i humbjes së pasurisë intelektuale të korporatës, mosha e shtyrë e stafit (mbi 50 vjeç) dhe mos përditësimi me njohuritë dhe zhvillimet e fundit të teknologjisë dhe shkencës, kostot mjekësore sipas obligimeve ligjore;

iv. Transaksionet e konsiderueshme që përfshijnë NP ose njësitë e saj ndihmëse

Të dhënat në reportin e mëposhtëm përfshijnë të gjitha kontratat e rëndësishme (për vlerat e parashikuara mbi 10.000 euro) të nënshkruara gjatë periudhës 01.01.2023-31.12.2023, pa marrë parasysh nëse ato kanë filluar para kësaj periudhe.

Nr.	Titulli i Kontratës	Data e nënshkrimit të Kontratës	Vlera e parashikuar e Kontratës	Çmimi i Kontratës	Operatori Ekonomik i Shpërblyer/KOMENTE
1	Punë tipike civile për infrastrukturën telekomunikuese në Regjionin e Prishtinës	13.01.2023	55,000.00	52,183.62	"L-Group" SH.P.K.
2	Punë tipike civile për infrastrukturën telekomunikuese në Regjionin e Prizrenit	13.01.2023	30,000.00	29,603.84	Multi Business Group SH.P.K.
3	Furnizim me shtylla Druri	21.02.2023	24,000.00	17,879.83	"TELEFONIKU"SH.P.K.
4	Shërbime dhe Furnizime me materiale marketingu	22.02.2023	93,650.00	67,680.00	G.I.Grafo - Loni SH.P.K.
5	Furnizimi me SAN (Storage Area Networks) dhe Server	03.03.2023	30,250.00	27,203.04	InterAdria L.L.C.
6	Furnizim me Karburante	31.03.2023	984,300.00	984,300.00	"Petrol Company" SH.P.K.,
7	Furnizimi me Tape Library LTO 8	14.03.2023	16,700.00	14,279.51	Infosoft Systems SH.P.K.
8	Sigurimi i Autopërgjegjësisë (TPL) për Automjetet zyrtare të Telekomit të Kosovës Sh.A	23.03.2023.	26,683.77	26,683.74	Kompania e Sigurimeve "SCARDIAN " J.S.C.
9	Shitia e Veturave të Vjetësuara*	31.03.2023.	32,729.00	59,717.74	<ul style="list-style-type: none"> • Nysret Citaku • Elhami Jashanica • Editor Danaj • Rinor Qorraj • Altin Memaj • Vllezrit e bashkuar SHPK • Etem Bajraktari • Avni Ademaj • Skender B. Sylejmani B.I.
10	Furnizim me Karburante	31.3.2023.	984,300.00	112,598.23	Petrol Company - SH.P.K.

11	Furnizimi dhe instalimi i klimave split sistem me gas R410a për centrale	20.4.2023.	40,000.00	39,742.40	Shkelqimi Invest SH.P.K.
12	Furnizim me material për zyre	27.4.2023.	24,583.50	15,386.49	MEDIATECH & PRINT SH.P.K.
13	Furnizimi dhe Implementimi i Platformës OTT	28.4.2023.	600,000.00	1,127,540.74	Grup i Operatorëve Ekonomik UniqCast; Cacttus Sh.a.
14	Furnizimi i SW licencave nga Nokia për 2G dhe 4G	15.5.2023.	64,000.00	69,890.00	Nokia Solutions and Networks Oy
15	Furnizim me pllaka të riparuara për mirëmbajtje dhe zgjerim të unazës IP MPLS dhe BRAS	22.5.2023.	65,282.00	68,768.00	TXO SYSTEMS LTD
16	Kabllo optike	26.6.2023.	54,200.00	47,745.88	Grup i Operatorëve Ekonomik FMC Telco d.o.o.; Botek shpk
17	Material për Kabllo për fije optike	29.6.2023.	29,000.00	26,055.93	" KOSPROD " SH.P.K.
18	Upgrade, migrimi harduerik në ISP storage dhe mirëmbajtja e platformës SMSC	22.6.2023.	128,600.00	128,000.00	KOSOVA INFORMATION TECHNOLOGY SH.A.
19	Mirëmbajtja e Platformës se Billingut POSTPAID-SYMPHONY	23.6.2023.	100,000.00	100,000.00	Integratouch LLC
20	Plotësimi Funksionale në CRM	23.6.2023.	174,350.00	173,247.60	VERSO ALTIMA D.O.O.-BRANCH IN KOSOVO
21	Furnizim me modema xDSL	29.6.2023.	60,000.00	51,991.20	" KOSPROD " SH.P.K.
22	Furnizim me pajisje OTDR e Fusion Splicer, për lidhje të SB-ëve me optikë	1.8.2023.	69,000.00	79,437.60	" FOTEK " SH.P.K.
23	Punët tipike civile për shtrirjen e rrjetit primar optik_Lot 3 Regjioni i Pejës	1.8.2023.	50,000.00	40,549.90	" GREEN CONSTRUCTION " SH.P.K.
24	Punët tipike civile për shtrirjen e rrjetit primar optik_Lot 4 Regjioni i Gjakovës	1.8.2023.	50,000.00	44,298.38	" GREEN CONSTRUCTION " SH.P.K.
25	Punët tipike civile për shtrirjen e rrjetit primar optik_Lot 5 Regjioni i Prizrenit	1.8.2023.	50,000.00	49,005.40	Grup i Operatorëve Ekonomik Ermal Dinaj B.I.; EKO-NIC GROUP

26	Furnizimi me material për zgjerimin dhe mirëmbajtjen e rrjetave telekomunikuese_Kabllo optike	18.9.2023.	400,000.00	284,227.78	Grup i Operatorëve Ekonomik BAK - ING SH.P.K.; ROA Consulting SH.P.K.
27	Furnizimi me material për zgjerimin dhe mirëmbajtjen e rrjetave telekomunikuese_Shtylla	18.9.2023.	11,000.00	10,384.00	Grup i Operatorëve Ekonomik BAK - ING SH.P.K.; ROA Consulting
28	Furnizimi me material për zgjerimin dhe mirëmbajtjen e rrjetave telekomunikuese_Gypa Lidhëse dhe Tapa	14.9.2023.	13,000.00	13,859.10	"TELEFONIKU"SH.P.K.
29	Furnizimi me material për zgjerimin dhe mirëmbajtjen e rrjetave telekomunikuese_Material për kabllo për Fije Optike	15.9.2023.	150,700.00	108,705.38	" KOSPROD " SH.P.K.
30	Furnizimi me material për zgjerimin dhe mirëmbajtjen e rrjetave telekomunikuese_Material ndihmës për Telekomin	15.9.2023.	35,000.00	30,231.60	" KOSPROD " SH.P.K.
31	Sistemi i integruar për monitorimin e platformave të rrjetit dhe siguri kibernetike	14.8.2023.	1,240,000.00	1,195,574.12	CLASTERTECH SH.P.K.
32	Material për pastrim	18.8.2023.	17,168.40	14,954.14	Ananas -Impex SH.P.K.
33	Furnizim me Plloter	25.8.2023.	16,000.00	15,222.00	" INFINITT " SH.P.K.
34	Furnizim me kanale televizive sportive	22.9.2023.	110,000.00	99,000.00	TRING TV SH.A.
35	Furnizimi me Server dhe SAN	28.9.2023.	175,000.00	110,979.72	InterAdria L.L.C.
36	Ndryshimet në furnizimet me HW, SW dhe shërbime për implementimin e Early RAN sipas projektit KeM	4.10.2023.	495,000.00	505,182.37	Ericsson Nikola Tesla d.d.
37	Furnizim me SB për modernizim të rrjetit radio	24.10.2023.	1,000,000.00	917,797.17	Ericsson Nikola Tesla d.d.
38	Plotësime funksionale në CRM	16.10.2023.	14,986.00	14,986.00	VERSO ALTIMA D.O.O.-BRANCH IN KOSOVO
39	Mirëmbajtje teknike dhe garacion harduerik për CRM Hardware për 1 vit	12.10.2023.	11,150.00	9,262.14	E - TECH SH.P.K.
40	Mirembajtja e Platformes se CRM-it	16.10.2023.	197,532.00	197,532.00	VERSO ALTIMA D.O.O.-BRANCH IN KOSOVO



41	Pune tipike civile për infrastrukturën telekomunikuese në Regjionin e Prishtinës	19.10.2023.	27,000.00	27,000.00	Ermal Dinaj B.I.
42	Furnizim me pajisje aktive për rrjeta optike	1.11.2023.	1,540,000.00	1,332,848.90	Nokia Solutions and Networks Oy
43	Furnizim me IP kapacitet në piken e caktuar	16.11.2023.	43,500.00	43,080.00	Neotel DOO
44	Furnizim me IP kapacitet në piken alternative	3.11.2023.	43,500.00	43,499.94	" TelKos " L.L.C.
45	Furnizim me pajisje për menaxhimin e gjeneratorëve nga distanca	4.12.2023.	23,000.00	22,375.27	TERMO LETËR SH.P.K.
	TOTALI :		9,400,164.67	8,450,490.70	

v. Sugjerime dhe propozime për ndryshime të cilat me arsyet pritet që ta rrisin performancën e korporatës

(kjo pjesë është plotësuar në kuadër të këtij raporti)

vi. Performanca e sistemeve telekomunikuese

Volumi kumulativ javor i trafikut mobil Voice dhe Data:



Indikatorët e performancës për vitin 2023

